

DIREKTIVA

DIREKTIVA (BE) 2016/680 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT

e 27 prillit 2016

për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN

Duke pasur parasysh Traktatin për Funkionimin e Bashkimit Evropian dhe veçanërisht nenin 16(2) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas komunikimit të projektaktit legjislativ te parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit të Rajoneve ⁽¹⁾,

Duke vepruar në pajtim me procedurën e zakonshme legjislative ⁽²⁾,

Ndërsa:

- (1) Mbrojtja e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale është një e drejtë themelore. Neni 8(1) i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ('Karta') dhe neni 16 (1) i Traktatit për Funkionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) parashikojnë që kushdo ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale që lidhen me të.
- (2) Parimet dhe rregullat për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale, pavarësisht shtetësisë apo vendbanimit të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore, veçanërisht të drejtën e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo Direktivë synon të kontribuojë në realizimin e një sfere lirie, sigurie dhe drejtësie.
- (3) Zhvillimet e shpejta teknologjike dhe globalizimi kanë sjellë sfida të reja për mbrojtjen e të dhënave personale. Shkalla e mbledhjes dhe e shkëmbimit të të dhënave personale është rritur në masë të konsiderueshme. Teknologjia lejon përpunimin e të dhënave personale në një masë të paprecedentë, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të tilla si: parandalimi, hetimi, zbulimi, ndjekja e veprave penale apo ekzekutimi i dënimeve penale.
- (4) Shkëmbimi i lirë i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit, ndjekjes penale të veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike brenda Bashkimit dhe transferimin e të dhënave personale te vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, duke siguruar një shkallë të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale. Këto zhvillime kërkojnë një kuadër të fuqishëm dhe më koherent për mbrojtjen e të dhënave brenda Bashkimit, të mbështetur nga ekzekutim të konsoliduar.
- (5) Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ⁽³⁾ zbatohet për përpunimin e të dhënave personale në Shtetet Anëtare, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Megjithatë, ajo nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale gjatë kryerjes së një aktiviteti që është jashtë qëllimit të ligjit të Komunitetit, si aktivitete në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështje penale dhe bashkëpunimin e policisë.

⁽¹⁾ GZ C 391, 18.12.2012, fq. 127.

(2) Qëndrimi i Parlamentit Evropian i datës 12 mars 2014 (i pabotuar ende në Fletoren Zyrtare) dhe qëndrimi i Këshillit në leximin e parë të datës 8 prill 2016 (i pabotuar ende në Fletoren Zyrtare). Qëndrimi i Parlamentit Evropian i datës 14 prill 2016.

(3) Direktiva 95/46/KEE Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 22 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (GZ L 281, 23.11.1995, fq. 31).

- (6) Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/977/JHA⁽¹⁾ zbatohet në të gjitha fushat e bashkëpunimit gjyqësor për çështje penale dhe bashkëpunimin e policisë. Fusha e zbatimit të Vendimit Kuadër kufizohet në përpunimin e të dhënave personale të transmetuara apo të vëna në dispozicion midis Shteteve Anëtare.
- (7) Garantimi i një niveli të njëtrajtshëm dhe të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale të personave fizikë dhe lehtësimi i shkëmbimit të të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare është i rëndësishëm në mënyrë që të sigurohet bashkëpunim efikas gjyqësor në çështjet penale dhe bashkëpunimin e policisë. Niveli i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen penale e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve të sigurisë publike, duhet të jetë i barasvlershëm në të gjithë Shtetet Anëtare. Mbrojtja e efektshme e të dhënave personale në të gjithë Bashkimin kërkon fuqizimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe detyrimeve të atyre që përpunojnë të dhënat personale, si dhe kompetenca të njëjta për monitorimin dhe garantimin e respektimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale në Shtetet Anëtare.
- (8) Neni 16(2) i TFBE-së autorizon Parlamentin Evropian dhe Këshillin të vendosin rregulla për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe rregulla për lëvizjen e lirë të të dhënave personale.
- (9) Rregullorja (BE) 2016/679 e Bashkimit Evropian dhe e Këshillit⁽²⁾ përcakton rregullat e përgjithshme për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave personale brenda Bashkimit.
- (10) Në Deklaratën Nr. 21 për mbrojtjen e të dhënave personale në fushat e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe bashkëpunimit të policisë, bashkëngjitur aktit përfundimtar të konferencës ndërqeveritare, e cila miratoi Traktatin e Lisbonës, konferenca pranoi se rregullat specifike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave personale në fushat e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe bashkëpunimit të policisë në bazë të nenit 16 të TFBE-së mund të rezultojnë të nevojshme për shkak të natyrës specifike të atyre fushave.
- (11) Rrjedhimisht është e nevojshme që këto fusha të adresohen nga një direktivë që përcakton rregullat specifike për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike, dhe duke respektuar natyrën specifike të këtyre aktiviteteve. Këto autoritete kompetente mund të jenë jo vetëm autoritetet publike si autoritetet gjyqësore, policia apo autoritetet ligjzbatuese, por edhe çdo organ apo entitet tjetër i ngarkuar nga ligji i Shteteve Anëtare për të ushtruar autoritetin publik dhe kompetenca publike për qëllimet e kësaj Direktive. Kur një organ ose subjekt i tillë përpunon të dhënat personale për qëllime të ndryshme nga qëllimet e kësaj Direktive, zbatohet Rregullorja (BE) 2016/679. Rregullorja (BE) 2016/679 zbatohet në rastin kur një organ ose entitet mbledh të dhëna personale me qëllim përbushjen e një detyrimi ligjor të cilit i nënshtrohet. Për shembull, për qëllime hetimi, zbulimi apo ndjekje të veprave penale, institucionet financiare mbajnë të dhëna personale të caktuara të cilat përpunohen nga ata dhe ia japin këto të dhëna vetëm autoriteteve kompetente kombëtare në raste specifike dhe në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar. Një organ ose entitet që përpunon të dhëna personale në emër të këtyre autoriteteve brenda qëllimit të kësaj Direktive duhet të lidhen me kontratë ose ndonjë akt tjetër ligjor dhe nga dispozitat përkatëse për përpunuesit sipas kësaj Direktive, ndërsa zbatimi i Rregullores (BE) 2016/679 mbetet i pacenuar për përpunimin e të dhënave personale nga përpunuesi jashtë fushëveprimit të kësaj Direktive.
- (12) Aktivitetet e kryera nga policia apo autoritete të tjera ligjzbatuese përqendrohen kryesisht në parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave penale, duke përfshirë aktivitete të policisë pa informacione paraprake nëse incidenti përbën vepër penale apo jo. Aktivitete të tilla mund të përfshijnë ushtrimin e autoritetit duke marrë masa shtrënguese, siç janë aktivitetet e policisë në demonstrata, ngjarje të mëdha sportive apo trazira. Ato gjithashtu përfshijnë mbajtjen e rendit dhe ligjit si një detyrë që i është dhënë policisë apo autoriteteve të tjera ligjzbatuese, ku është e nevojshme, për garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike dhe interesat themelore të shoqërisë të mbrojtur me ligj, që mund të çojnë në shkelje penale. Shtetet Anëtare mund t'i ngarkojnë autoriteteve kompetente detyra që nuk kryhen domosdoshmërisht me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, në mënyrë që përpunimi i të dhënave personale për këto qëllime të tjera, për sa kohë është brenda fushëveprimit të ligjit të Bashkimit Evropian, përfshihet edhe në fushëveprimin e Rregullores (BE) 2016/679.

(1) Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/977/JHA i 27 nëntor 2008 mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuar në kuadrin e bashkëpunimit gjyqësor dhe të të policisë në çështjet penale (GZL350,30.12.2008, fq. 60).

(2) Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 prillit 2016 mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale mbi lirinë e lëvizjes së këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC (Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave) (shih faqen 1 të Gazetës Zyrtare).

- (13) Në kuptim të kësaj Direktive, një vepër penale parashikohet si koncept autonom i së drejtës së Bashkimit sipas interpretimit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian ('Gjykata e Drejtësisë').
- (14) Kjo Direktivë nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale gjatë aktivitetit jashtë fushëveprimit të së drejtës së Bashkimit, aktivitete që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, aktivitetet e agjencive apo njërive që merren me çështjet e sigurisë kombëtare dhe përpunimin e të dhënave personale nga Shtetet Anëtare, kur kryerja e aktiviteteve në objektin e Kreut 2 të Titullit V të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) nuk konsiderohen si aktivitete brenda fushëveprimit të kësaj Direktive.
- (15) Me qëllim garantimin e një niveli të njëtrajtshëm të mbrojtjes për personat fizike në të gjithë Bashkimin dhe parandalimin e divergjencave që pengojnë lëvizjen e lirë të të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente, kjo Direktivë duhet të parashikojë rregulla të harmonizuara për mbrojtjen dhe lëvizjen e lirë të të dhënave personale të përpunuar me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe mbrojtjen nga kërcënimet për sigurinë publike. Përafrimi i ligjeve të Shteteve Anëtare nuk duhet të rezultojë në ulje të shkallës së mbrojtjes së të dhënave personale, por përkundrazi duhet të sigurojë një nivel të lartë mbrojtje brenda Bashkimit. Shtetet Anëtare nuk duhet të pengohen në dhënien e garancive më të larta se ato të përcaktuara në këtë Direktivë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjektit të të dhënave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente.
- (16) Kjo Direktivë lejon marrjen parasysh të parimit të aksesit publik në dokumentet zyrtare gjatë zbatimit. Sipas Rregullores (BE) 2016/679 të dhënat personale në dokumentet zyrtarë të mbajtura nga një autoritet publik ose organ publik ose privat të kryera në interes publik mund të deklarohen nga ai autoritet ose organ në përputhje me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet autoriteti ose organi publik, me qëllim përshtatjen e aksesit publik me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në dokumentet zyrtare.
- (17) Mbrojtja e parashikuar nga kjo Direktivë zbatohet për personat fizikë, pavarësisht shtetësisë apo vendbanimit, në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale.
- (18) Për të parandaluar rrezikun serioz të shmangies, mbrojtja e personave fizikë nuk duhet të ndikohet nga teknologjia dhe të mos varet nga teknikat e përdorura. Mbrojtja e personave fizikë duhet të zbatohet në përpunimin e të dhënave personale me mjete automatike, ashtu dhe në përpunimin manual të tyre, nëse të dhënat personale gjenden ose synohen të gjenden në një sistem skedimi. Dosjet ose kompletet e dosjeve, si dhe dokumentet e tyre shoqëruese, të cilat nuk janë të strukturuar sipas kriterëve specifike nuk duhet të përfshihen në fushëveprimin e kësaj Direktive.
- (19) Rregullorja (KE) Nr. 45/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ⁽¹⁾ zbatohet për përpunimin e të dhënave nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit. Rregullorja (KE) Nr. 45/2001 dhe aktet e tjera ligjore të Bashkimit, të zbatueshme për përpunimin e tillë të të dhënave personale duhet të përshtatet me parimet dhe rregullat e përcaktuara në Rregulloren (BE) 2016/679.
- (20) Kjo Direktivë nuk i pengon Shtetet Anëtare që të përcaktojnë veprime dhe procedura të përpunimit në rregulloret kombëtare për procedurën penale në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga gjykatat dhe autoritete të tjera gjyqësore, veçanërisht lidhur me të dhënat personale në vendime gjyqësore apo të dhëna lidhur me procedurat penale.

⁽¹⁾Rregullorja (KE) Nr. 45/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 dhjetorit 2000 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (GZL8, 12.1.2001, fq.1).

- (21) Parimet e mbrojtjes së të dhënave duhet të zbatohen për çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm. Për të përcaktuar nëse një person është i identifikueshëm, duhet të merren parasysh të gjitha mjetet që mund të përdoren normalisht, si veçimi, qoftë nga kontrolluesi apo një person tjetër për të identifikuar personin fizik drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë. Për të përcaktuar nëse mjetet janë normalisht të përshtatshme për t'u përdorur për identifikimin e personit fizik, duhet të merren parasysh të gjithë faktorët objektivë, si kostoja dhe sasia e kohës që kërkohet për identifikimin, duke marrë parasysh teknologjinë e disponueshme në momentin e përpunimit dhe zhvillimet teknologjike. Parimet e mbrojtjes së të dhënave nuk duhen përdorur për informacionin anonim, që është informacioni i cili nuk lidhet me një person fizik të identifikueshëm ose të identifikuar apo me të dhënat personale të bëra anonime në një mënyrë të tillë që subjekti i të dhënave nuk është ose nuk vazhdon të jetë i identifikueshëm.
- (22) Autoritetet publike të cilëve u deklarohen të dhënat personale në përmbushje të një detyrimi ligjor për ushtrimin e misionit të tyre zyrtar, si autoritetet tatimore dhe doganore, njësitë e hetimit financiar, autoritetet e pavarura administrative, ose autoritetet e tregut financiar përgjegjëse për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të letrave me vlerë nuk duhet të konsiderohen si marrës, nëse ata marrin të dhëna personale që janë të nevojshme për të kryer një hetim të caktuar në interesin e përgjithshëm, në pajtim me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar. Kërkesat për deklarim të dërguara nga autoritetet publike duhet të jenë gjithmonë me shkrim, të arsyetuara dhe konkrete dhe nuk duhet të kenë të bëjnë me tërësinë e sistemit të skedimit ose të çojnë në ndërlikimin e sistemeve të skedimit. Përpunimi i të dhënave personale nga këto autoritete publike duhet të respektojë rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave në përputhje me qëllimin e përpunimit.
- (23) Të dhënat gjenetike duhet të përkufizohen si të dhëna personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të përfuara të një personi fizik që rezulton nga analiza e një kampioni biologjik të personit fizik në fjalë, veçanërisht analizën kromozomale, nga acidi dezoksiribonukleik (ADN) ose nga acidi ribonukleik (ARN), ose nga analiza e një elementi tjetër që mundëson marrjen e informacionit të barasvlershëm. Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e të dhënave gjenetike, ekziston një rrezik i madhi keqpërdorimit dhe ripërdorimit për qëllime të ndryshme nga kontrolluesi. Në parim, çdo diskriminim i bazuar në karakteristikat gjenetike duhet të ndalohet.
- (24) Të dhënat personale në lidhje me shëndetin duhet të përfshijnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore të një subjekti të të dhënave që tregojnë informacionin në lidhje me gjendjen shëndetësore fizike dhe mendore të shkuar, të tashme ose të ardhme të subjektit të të dhënave. Kjo përfshin informacionin në lidhje me personin fizik të marrë në kuadrin e regjistrimit ose dhënies së shërbimeve të kujdesit shëndetësore sipas Direktivës 2011/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽¹⁾ të atij personi fizik; një numër, simbol ose hollësi e caktuar e një personi fizik për të identifikuar në mënyrë unike personin fizik për qëllime shëndetësore; informacioni i marrë nga testimi ose vizita e një pjese të trupit ose substance të trupit, duke përfshirë të dhënat gjenetike dhe kampionët biologjikë; dhe çdo informacion, për shembull, në lidhje me një sëmundje, paaftësi, rrezik serioz, sëmundje të mëparshme, trajtim mjekësor ose gjendje fiziologjike ose bio-mjekësore të subjektit të të dhënave pavarësisht nga burimi, për shembull nga një mjek ose një profesionist tjetër i shëndetit, një spital, aparat mjekësor apo një testim diagnostikues in vitro.
- (25) Të gjitha Shtetet Anëtare janë të lidhura me Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol). Për të përmbushur misionin e saj, Interpol merr, ruan dhe përdortë dhënat personale për të ndihmuar autoritetet kompetente në parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkombëtar. Prandaj është i nevojshëm forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit dhe Interpolit, duke promovuar një shkëmbim efikas të të dhënave personale, duke siguruar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale. Kjo Direktivë zbatohet kur të dhënat personale transferohen nga Bashkimi në Interpol dhe në vendet që kanë anëtarë të deleguar në Interpol, dhe në veçanti dispozitat për transferimet ndërkombëtare. Kjo Direktivë duhet të zbatohet pa paragjykimë ndaj rregullave specifike të përcaktuara në Qëndrimin e Përbashkët të Këshillit 2005/69/JHA ⁽²⁾ dhe Vendimin e Këshillit 2007/533/JHA ⁽³⁾.
- (26) Çdo përpunim i të dhënave personale duhet të jetë i ligjshëm, i drejtë dhe transparent për personat fizikë që të dhënat personale të përpunohen për qëllime specifike të përcaktuara në ligj. Kjo nuk pengon autoritetet ligjzbatuese për të kryer aktivitete të tilla si: hetime të fshehta apo video survejimi. Aktivitete të tilla mund të bëhen me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve të sigurisë publike, për sa kohë janë të vendosura me ligj dhe përbëjnë një masë të nevojshme dhe proporcionale

(1) Direktiva 2011/24/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 9 marsit 2011 në lidhje me zbatimin e të drejtave të pacientëve në fushën e kujdesit shëndetësor ndërkufitar (GZL 88, 4.4.2011, fq. 45).

(2) Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2005/69/JHA i 24 janarit 2005 për shkëmbimin e të dhënave të caktuara me Interpol (OJL 27, 29.1.2005, fq. 61).

(3) Vendim i Këshillit 2007/533/JHA i 12 qershorit 2007 mbi ngritjen, funksionimin dhe përdorimin e Sistemit të Informacionit Shengen të gjeneratës së dytë (SIS II) (GZL 205, 7.8.2007, fq. 63).

në një shoqëri demokratike, duke pasur parasysh interesat legjitime të personit fizik në fjalë. Parimi i mbrojtjes së të dhënave të përpunimit të drejtë është një nocion i veçantë nga e drejta për gjykim të drejtë parashikuar në nenin 47 të Kartës dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ). Personat fizikë duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për rreziqet, rregullat, garancitë dhe të drejtat në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe sitë ushtrojnë të drejtat e tyre në lidhje me një përpunim të tillë. Më konkretisht, qëllimet specifike për të cilat përpunohen të dhënat personale duhet të jenë të qarta dhe legjitime dhe të përcaktuara në momentin e mbledhjes së të dhënave personale. Të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në atë që është e nevojshme për qëllimet për të cilat ato përpunohen. Kjo kërkon veçanërisht garantimin që periudha për të cilën ruhen të dhënat personale të jetë e kufizuar në një minimum rigoroz. Të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm nëse qëllimi i përpunimit nuk mund të përmbushet në shkallë të arsyeshme me mjete të tjera. Me qëllim që të garantohet që të dhënat personale nuk mbahen më gjatë nga sa është e nevojshme, kontrolluesi duhet të përcaktojë afatet kohore nga kontrolluesi për fshirjen apo për një rishikim periodik. Shtetet Anëtare duhet të marrin çdo masë të arsyeshme për të garantuar që të dhënat personale të ruhen për periudha kohore më të gjata për arkivim në interes publik, përdorim statistikor apo historik.

- (27) Për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, është e nevojshme që autoritetet kompetente të përpunojnë të dhënat personale të mbledhura në kontekstin e parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes penale të veprave të veçanta penale përtej këtij konteksti me qëllim të kuptuarit e veprave penale të veçanta dhe krijimit të lidhjeve ndërmjet veprave penale të ndryshme të zbuluara.
- (28) Me qëllim ruajtjen e sigurisë në lidhje me përpunimin dhe parandalimin e përpunimit në shkelje të kësaj Direktive, të dhënat personale duhet të përpunohen në një mënyrë që garanton sigurinë dhe konfidencialitetin e duhur për të dhënat personale, duke përfshirë parandalimin e aksesit ose përdorimit të paautorizuar të të dhënave personale dhe pajisjeve që përdoren për përpunimin e tyre dhe kjo merr parasysh gjendjen e disponueshme të artit dhe teknologjisë, kostot e zbatimit në lidhje me rreziqet dhe natyrën e të dhënave personale që duhet të mbrohen.
- (29) Të dhënat personale duhet të mblidhen për qëllime specifike, të qarta dhe legjitime brenda fushëveprimet të kësaj Direktive dhe nuk duhet të përpunohen për qëllime të papajtueshme me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimit të dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike. Nëse të dhënat personale përpunohen nga i njëjti ose një kontrollues tjetër për një qëllim brenda objektit të kësaj Direktive përveç atij për të cilin është mbledhur, përpunim i tillë duhet të lejohet me kusht që përpunimi të jetë i autorizuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe është i domosdoshëm dhe proporcional me atë qëllim.
- (30) Parimi i saktësisë së të dhënave duhet të zbatohet duke marrë parasysh natyrën dhe qëllimin e përpunimit në fjalë. Në veçanti, në proceset gjyqësore, deklaratat që përmbajnë të dhëna personale bazohen në perceptimin subjektiv të personave fizikë dhe nuk janë gjithmonë të verifikueshme. Për rrjedhojë, kërkesa për saktësi nuk duhet të lidhet me saktësinë e një deklaratë, por vetëm me faktin se është bërë një deklaratë specifike.
- (31) Është e natyrshme që për përpunimin e të dhënave personale në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe bashkëpunimin policor të përpunohen të dhënat personale që lidhen me kategoritë e ndryshme të subjekteve të të dhënave. Prandaj, një dallim i qartë duhet të bëhet, kur është e mundur dhe sa të jetë e mundur ndërmjet të dhënave personale të kategorive të ndryshme të subjekteve të të dhënave si: të dyshuarit; personat e dënuar për vepra penale; viktimat dhe palë të tjera, dëshmitarë; persona që kanë informacion ose kontakte përkatëse; dhe bashkëpunëtorët e të dyshuarve dhe kriminelëve të dënuar. Kjo nuk duhet të parandalojë zbatimin e së drejtës së prezumimit të pafajësisë, siç garantohet nga Karta dhe KEDNJ, dhe siç interpretohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- (32) Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që të dhënat personale që janë të pasakta, të paplota apo jo të përditësuara të mos transmetohen apo të vihen në dispozicion. Për të siguruar mbrojtjen e personave fizikë, saktësinë, plotësinë ose shkallën në të cilën të dhënat personale janë të përditësuara dhe besueshmërinë e të dhënave personale të transmetuara apo të vëna në dispozicion, autoritetet kompetente duhet të shtojnë sa të jetë e mundur informacionin e nevojshëm në të gjitha transmetimet e të dhënave personale.
- (33) Nëse kjo Direktivë i referohet një ligji, baze ligjore ose një mase legislative të një Shteti Anëtar, kjo nuk kërkon domosdoshmërisht që një akt legjislativ të miratohet nga Parlamenti, pa cenuar kërkesat në pajtim me rendin kushtetues të Shtetit Anëtar të interesuar. Megjithatë, një ligj i tillë, bazë ligjore apo masë legislative e Shtetit Anëtar duhet të jetë i qartë dhe i saktë dhe zbatimi i tij duhet të jetë i parashikueshëm për personat që i nënshtrohen, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Legjislati i Shtetit Anëtar që rregullon përpunimin e të dhënave personale në fushën e veprimit të kësaj Direktive duhet të specifikojë të paktën objektivat, të dhënat personale që duhet të përpunohen, qëllimet e përpunimit dhe procedurat për ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave personale dhe procedurat për shkatërrimin e tij, duke dhënë garanci të mjaftueshme kundër rrezikut të abuzimit dhe arbitraritetit.

- (34) Përpunimi i të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike, duhet të mbulojë çdo operacion apo grup operacionesh që kryhen me të dhënat personale ose grupet e të dhënave personale, me mjete automatike ose jo, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në veçanti, rregullat e kësaj Direktive zbatohen për transmetimin e të dhënave personale për qëllimet e kësaj Direktive për një marrës që nuk është objekt i kësaj Direktive. Një marrës i tillë mund të jetë një person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo çdo organ tjetër në të cilin të dhënat personale janë bërë publike në mënyrë të ligjshme nga autoriteti kompetent. Kur të dhënat personale janë mbledhur fillimisht nga një autoritet kompetent për një nga qëllimet e kësaj Direktive, duhet të zbatohet Rregullorja (BE) 2016/679 për përpunimin e këtyre të dhënave për qëllime të ndryshme nga qëllimet e kësaj Direktive, kur një përpunim i tillë është autorizuar nga legjislati i Bashkimit apo Shtetit Anëtar. Në veçanti, rregullat e Rregullores (BE) 2016/679 duhet të zbatohen për transmetimin e të dhënave personale për qëllime jashtë fushëveprimit të kësaj Direktive. Për përpunimin e të dhënave personale nga një marrës që nuk është autoritet kompetent apo që nuk vepron si i tillë në kuptim të kësaj Direktive dhe për të cilin të dhënat personale janë bërë publike në mënyrë të ligjshme nga një autoritet kompetent duhet të zbatohet Rregullorja (BE) 2016/679. Gjithashtu, gjatë zbatimit të kësaj Direktive, Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë më tej zbatimin e rregullave të Rregullores (BE) 2016/679, në përputhje me kushtet e përcaktuara.
- (35) Me qëllim që të jetë i ligjshëm, përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë i nevojshëm për mbarëvajtjen e një detyre të kryer për interes publik nga një autoritet kompetent bazuar në ligjin e Bashkimit apo Shteti Anëtar me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike. Këto aktivitete duhet të mbulojnë mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave. Kryerja e detyrave për parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave penale të autorizuar me ligj nga autoritetet kompetente lejon që ata të kërkojnë ose të urdhërojnë persona fizikë që të pajtohen me kërkesat e bëra. Në një rast të tillë, pëlqimi i subjektit të të dhënave, siç përcaktohet në Rregulloren (BE) 2016/679, nuk duhet të sigurojë një bazë ligjore për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente. Kur subjekti i të dhënave kërkohet të pajtohet me një detyrim ligjor, subjekti i të dhënave nuk ka zgjedhje reale dhe të lirë, kështu që reagimi i subjektit të të dhënave nuk mund të konsiderohet tregues i dhënë lirisht për dëshirat e tij ose të saj. Kjo nuk duhet të pengojë që Shtetet Anëtare të sigurojnë me ligj që subjekti i të dhënave të pajtohet me përpunimin e të dhënave personale të tij ose të saj për qëllimet e kësaj Direktive, siç janë testet e ADN-së në hetimet penale ose monitorimin e vendndodhjes së tij/saj me pajisje elektronike gjurmuese për ekzekutimin e dënimeve penale.
- (36) Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë se e drejta e Bashkimit apo Shtetit Anëtar të jetë e zbatueshme për autoritetin kompetent transmetues për kushtet specifike në rrethana të veçanta për përpunimin e të dhënave personale, si dhënia e kodeve, autoriteti kompetent transmetues duhet të informojë marrësin e këtyre të dhënave personale mbi kushtet dhe kërkesat për t'i zbatuar ato. Kushte të tilla përfshijnë, si për shembull, ndalimin e transmetimit të të dhënave personale te të tjerë apo përdorimit të tyre për qëllime të tjera nga ato të transmetuara marrësit, ose informimin e subjektit të të drejtave në rast të kufizimit të së drejtës së informimit pa pëlqimin paraprak të autoritetit kompetent transmetues. Këto detyrime duhet të zbatohen për transferimet nga autoriteti kompetent transmetues te marrësit në vende të treta apo organizata ndërkombëtare. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë se autoriteti kompetent transmetues nuk duhet të zbatojë kushte të tilla për marrësit në Shtetet Anëtare apo agjenci, zyra dhe organe të krijuara në përputhje me Krerët 4 dhe 5 të Titullit V të TFBE-së, përveç atyre të zbatueshëm për transmetimet e të dhënave të njëjta brenda Shtetit Anëtar të autoritetit kompetent.
- (37) Të dhënat personale që sipas natyrës së tyre janë tepër të ndjeshme në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore meritojnë mbrojtje të veçantë pasi në kontekstin e përpunimit të tyre mund të krijohen rreziqe të konsiderueshme për të drejtat dhe liritë themelore. Këto të dhëna personale duhet të përfshijnë të dhënat personale që tregojnë racën ose origjinën etnike, ku përdorimi i termit 'përkatësi racore' në këtë Direktivë nuk tregon që Bashkimi Evropian pranon teorinë të cilat synojnë të përcaktojnë ekzistencën e racave të veçanta njerëzore. Këto të dhëna personale nuk duhet të përpunohen, përveç kur përpunimi është objekt i garancive për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave parashikuar me ligj dhe lejohet në raste të veçanta të përcaktuara me ligj; kur nuk është i lejuar me ligj, përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave ose çdo personi tjetër; ose kur përpunimi lidhet me të dhënat të cilat bëhen publike nga subjekti i të dhënave. Mbrojtja për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave mund të përfshijë mundësinë për të mbledhur këto të dhëna vetëm në lidhje me të dhënat e tjera për personin fizik në fjalë, mundësinë për të siguruar të dhënat e mbledhura në mënyrë të duhur, rregulla më të rrepta për aksesin e stafit të autoritetit kompetent në të dhënat dhe ndalimi i transmetimit të këtyre të dhënave. Përpunimi i të dhënave të tilla duhet të lejohet me ligj kur subjekti i të dhënave ka pranuar në mënyrë të shprehur që përpunimi është ndërhyrës. Megjithatë, pëlqimi i subjektit të të dhënave nuk duhet të sigurojë në vetvete një bazë ligjore për përpunimin e të dhënave personale të ndjeshme nga autoritetet kompetente.

- (38) Subjekti i të dhënave duhet të ketë të drejtën të mos i nënshtrohet një vendimi i cili vlerëson aspekte personale në lidhje me të, që bazohet vetëm në përpunimin automatik dhe që sjellë efekte ligjore në lidhje me të ose e ndikon atë në mënyrë të ndjeshme. Në çdo rast, një përpunim i tillë duhet t'iu nënshtrohet garancive të përshtatshme, që duhet të përfshijnë informacionin specifik për subjektin e të dhënave dhe të drejtën për të kërkuar ndërhyrje njerëzore, për të shprehur mendimin e tij ose të saj, për të marrë një shpjegim lidhur me vendimin e marrë pas një vlerësimi të tillë dhe për të kundërshtuar vendimin. Profilizimi që rezulton në diskriminim ndaj personave fizikë në bazë të të dhënave personale, të cilat janë nga natyra veçanërisht të ndjeshme në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore duhet të ndalohen vetëm në kushtet e përcaktuara në nenet 21 dhe 52 të Kartës.
- (39) Me qëllim ushtrimin e të drejtave të tij/saj, çdo informacion për subjektin e të dhënave duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm, duke përfshirë faqe interneti të kontrolluesit, lehtësisht e kuptueshme, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të kuptueshme. Informacion i tillë duhet të përshtatet për nevojat e personave vulnerabël, si fëmijët.
- (40) Duhet të parashikohen modalitetet për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave sipas kësaj Direktive, duke përfshirë mekanizmat për të kërkuar dhe, sipas rastit, për të përfituar falas, veçanërisht, aksesin dhe korrigjimin apo fshirjen e të dhënave personale dhe ushtrimin e së drejtës së kundërshtimit. Kontrolluesi duhet të jetë i detyruar t'iu përgjigjet kërkesave të subjekteve të të dhënave pa vonesa të panevojshme, vetëm nëse kontrolluesi zbaton kufizimet e të drejtave të subjektit të të dhënave në përputhje me këtë Direktivë. Për më tepër, nëse kërkesat janë të pabazuara ose të tepërta, kur subjekti i të dhënave kërkon informacion në mënyrë të përsëritur dhe të paarsyetuar apo kur subjekti i të dhënave abuzon me të drejtën e tij/saj për të marrë informacion, për shembull, duke dhënë informacion të rremë kur bën kërkesën, kontrolluesi mund të caktojë një tarifë të arsyeshme ose të refuzojë të veprojë në lidhje me kërkesën.
- (41) Kur kontrolluesi kërkon informacion shtesë të nevojshëm për të konfirmuar identitetin e subjektit të të dhënave, ai informacion duhet të përpunohet vetëm për qëllimin përkatës, dhe nuk duhet të ruhet për më shumë sesa është e nevojshme për atë qëllim.
- (42) Subjektit të të dhënave i jepet të paktën informacioni i mëposhtëm: identiteti i kontrolluesit, ekzistenca e përpunimit, qëllimet e përpunimit, e drejta e ankimit dhe ekzistenca e së drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi akses dhe korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit. Një informacion i tillë mund të jepet nëpërmjet një faqe interneti të autoritetit kompetent. Për më tepër, në raste të caktuara dhe me qëllim ushtrimin e të drejtave të tij/saj, subjekti i të dhënave duhet të informohet mbi bazën ligjore për përpunimin dhe afatin për të cilin ruhen të dhënat personale për aq sa ky informacion është i nevojshëm, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta në të cilat përpunohen të dhënat për të garantuar një përpunim të drejtë për subjektin e të dhënave.
- (43) Një person fizik duhet të ketë të drejtën e aksesit të të dhënave personale që janë mbledhur në lidhje me të dhe të ushtrojë këtë të drejtë me lehtësi dhe intervale të arsyeshme, me qëllim që të jetë në dijeni dhe të verifikojë ligjshmërinë e përpunimit. Çdo subjekt të dhënash duhet të ketë të drejtën të njohë dhe të përftojë komunikim veçanërisht në lidhje me qëllimet për të cilat janë përpunuar të dhënat personale, afatin për të cilin janë përpunuar të dhënat personale, marrësit e të dhënave personale, duke përfshirë ato në vende të treta. Kur komunikime të tilla përfshijnë informacione si origjina e të dhënave personale, informacioni nuk duhet të zbulojë identitetin e personave fizikë, në veçanti burime konfidenciale. Për të zbatuar këtë të drejtë, mjafton që subjekti i të dhënave të ketë një përmbledhje të plotë të këtyre të dhënave në një formë të kuptueshme, që do të thotë një formë e cila e mundëson subjektin e të dhënave të jetë në dijeni për këto të dhëna dhe të verifikojë që janë të sakta dhe të përpunuar në përputhje me këtë Direktivë, mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tij/saj të dhënave nga kjo Direktivë. Një përmbledhje e tillë mund të jepet në formë e një kopje të të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit.

- (44) Shtetet Anëtare duhet të miratojnë masa legislative që përcaktojnë vonesat, kufizimet dhe përjashtimet e informacionit për subjektet e të dhënave ose kufizimin, të plotë ose të pjesshëm, të aksesit në të dhënat personale në masën dhe kur një kufizim i tillë përbën një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për të garantuar të drejtat themelore dhe interesat legjitime të personit fizik në fjalë, për të shmangur pengimin e kërkesave, hetimeve apo procedurave zyrtare apo ligjore, për të shmangur paragjykimin për parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, mbrojtjen e sigurisë publike ose sigurisë kombëtare, apo mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve. Kontrolluesi duhet të vlerësojë, me anë të një shqyrtimi konkret dhe individual të secilit rast, nëse e drejta e aksesit duhet të jetë pjesërisht ose tërësisht e kufizuar.
- (45) Çdo refuzim apo kufizim i aksesit duhet në parim të përcaktohet me shkrim për subjektin e të dhënave personale dhe përfshin arsyet faktike ose ligjore ku bazohet vendimi.
- (46) Çdo kufizim i të drejtave të subjektit të të dhënave duhet të jetë në pajtim me Kartën dhe KEDNJ, sipas interpretimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe në veçanti të respektojë thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive.
- (47) Një person fizik duhet të ketë të drejtën të korrigjojë të dhënat personale të pasakta lidhur me të dhe të drejtën e fshirjes kur përpunimi i këtyre të dhënave shkel këtë Direktivë. Megjithatë, e drejta për korrigjim nuk duhet të ndikojë, për shembull, në përmbajtjen e dëshmisë së dëshmitarit. Një person fizik duhet të ketë të drejtën e kufizimit të përpunimit kur ai/ajo kundërshton saktësinë e të dhënave personale. dhe kur saktësia ose pasaktësia nuk mund të konstatohet ose kur të dhënat personale duhet të mbahen me qëllim provash. Veçanërisht, në vend të fshirjes së të dhënave personale, përpunimi duhet të kufizohet nëse në një rast specifik ka baza të arsyetuara për të besuar se fshirja mund të ndikojë në interesat legjitime të subjektit të të dhënave. Në këtë rast, të dhënat e kufizuara duhet të përpunohen vetëm për qëllimin që pengonte fshirjen e tyre. Metodot për të kufizuar përpunimin e të dhënave personale mund të përfshijnë, ndër të tjerash, lëvizjen e të dhënave të zgjedhura në një sistem tjetër përpunimi, për shembull për qëllime arkivimi, ose mosvënia në dispozicion e të dhënave të përzgjedhura. Në sistemet automatike të arkivimit kufizimi i përpunimit duhet në parim të sigurohet me mjete teknike. Fakti që përpunimi i të dhënave personale është i kufizuar duhet të ilustrohet në sistem në mënyrë të tillë që të jetë e qartë se përpunimi i të dhënave personale është i kufizuar. Ky korrigjim apo fshirje e të dhënave personale ose kufizimi i përpunimit duhet t'u komunikohet marrëseve të cilëve u janë zbuluar të dhënat dhe autoriteteve kompetente nga të cilat kanë ardhur të dhëna të pasakta. Gjithashtu, kontrollorët nuk duhet të përfshihen në shpërndarjen e këtyre të dhënave.
- (48) Kur kontrolluesi i mohon subjektit të të dhënave të drejtat e informimit, aksesit apo korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit, subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë që autoriteti kombëtar mbikëqyrës të verifikojë ligshmërinë e përpunimit. Subjekti i të dhënave duhet të informohet për këtë të drejtë. Kur autoriteti mbikëqyrës vepron në emër të subjektit të të dhënave, subjekti i të dhënave duhet të informohet nga autoriteti mbikëqyrës të paktën në lidhje me të gjitha verifikimet apo shqyrtimet e nevojshme që janë kryer nga autoriteti mbikëqyrës. Autoriteti mbikëqyrës duhet gjithashtu të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për të kërkuar një zgjidhje juridike.
- (49) Kur përpunohen të dhëna në lidhje me hetime penale dhe procedura gjyqësore në çështje penale, Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë se ushtrimi i të drejtës së informimit, aksesit dhe korrigjimit apo fshirjes së të dhënave personale dhe kufizimit të përpunimit të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar për procedurat gjyqësore.
- (50) Duhet të vendoset përgjegjësia dhe detyrimi i kontrolluesit për çdo përpunim të të dhënave personale të kryer nga kontrolluesi ose në emër të tij. Më konkretisht, kontrolluesi duhet të jetë i detyruar të zbatojë masa të përshtatshme dhe efektive dhe të jetë në gjendje të provojë përputhshmërinë e aktiviteteve përpunuese kundrejt kësaj Direktive, duke përfshirë efektivitetin e masave. Këto masa duhet të marrin parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit dhe rreziqet për të drejtat dhe liritë e personave fizikë. Masat e marra nga kontrolluesi duhet të përfshijnë hartimin dhe zbatimin e garancive specifike lidhur me trajtimin e të dhënave personale të personave fizikë të pambrojtur, si fëmijët.
- (51) Rreziku për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, me shkallë të ndryshme probabiliteti dhe serioziteti, mund të rezultojë nga përpunimi i të dhënave personale që mund të çojnë në dëmtim fizik, material ose jomaterial, sidomos: nëse përpunimi mund të bëhet shkak për diskriminim, vjedhje identiteti apo mashtrim, humbje financiare, dëm të reputacionit, humbje besueshmërie për të dhënat personale që ruhen nga konfidencialiteti profesional, kthimi i paautorizuar i pseudonimizimit, ose çdo dëm tjetër ekonomik ose social; nëse subjektet e të dhënave mund t'u hiqen të drejtat dhe liritë ose të pengohen në ushtrimin e kontrollit mbi të dhënat e tyre personale; nëse përpunohen të dhëna personale të cilat tregojnë racën ose origjinën etnike, bindjet politike, besimet fetare dhe filozofike, anëtarësinë në sindikatat profesionale dhe përpunimi i të dhënave gjenetike, të dhënat në lidhje me shëndetin ose të dhënat në lidhje me jetën seksuale ose dënimet dhe veprat penale ose masat përkatëse të sigurisë; nëse vlerësohen aspekte personale,

veçanërisht analiza dhe parashikimi i aspekteve në lidhje me performancën në punë, gjendjen ekonomike, shëndetin, preferencat ose interesat personale, besueshmërinë ose sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet, me qëllim që të krijohen ose përdoren profile personale; nëse përpunohen të dhënat personale të personave fizikë të pambrojtur, veçanërisht për fëmijët; apo nëse përpunimi përfshin një masë të madhe të të dhënave personale dhe ka të bëjë me një numër të madh të subjekteve të të dhënave.

- (52) Probabiliteti dhe serioziteti i rrezikut për të drejtat dhe liritë e të dhënave duhet të përcaktohet duke iu referuar natyrës, objektit, kontekstit dhe qëllimeve të përpunimit. Rreziku duhet të vlerësohet mbi bazën e një gjykimi objektiv, nëpërmjet të cilit vendoset nëse operacionet për përpunimin e të dhënave kanë të bëjnë me një rrezik të madh. Rreziku i lartë është një rrezik i veçantë i paragjykit të të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave.
- (53) Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale kërkon marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar që të përmbushen kërkesat e kësaj Direktive. Zbatimi i këtyre masave nuk duhet të varet vetëm në konsiderata ekonomike. Për të qenë në gjendje që të provohet përputhshmëria me këtë Direktivë, kontrolluesi duhet të miratojë politikatat e brendshme dhe të zbatojë masat që përmbushin veçanërisht parimet e mbrojtjes së të dhënave në mënyrë konkrete dhe mbrojtjes së të dhënave në mënyrë rastësore. Këto masa mund të konsistojnë, ndërmyjet të tjerash, në përdorimin sa më shpejt të jetë e mundur të pseudonimizimit. Përdorimi i pseudonimizimit për qëllime të kësaj Direktive mund të shërbejë si një mjet që mund të lehtësojë, sidomos shkëmbimin e të dhënave personale në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.
- (54) Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave si dhe përgjegjësia dhe detyrimi i kontrolluesve dhe përpunuesve, edhe në lidhje me monitorimin dhe masat e autoriteteve mbikëqyrëse, kërkon përcaktim të qartë të përgjegjësisë sipas kësaj Direktive, duke përfshirë nëse një kontrollues vendos qëllimet dhe mjetet e përpunimit së bashku me kontrollues të tjerë apo nëse një operacion përpunimi kryhet në emër të kontrolluesit.
- (55) Kryerja e përpunimit nga një përpunues duhet të rregullohet me akt ligjor, duke përfshirë lidhjen e një kontrate ndërmjet përpunuesit dhe kontrolluesit duke parashikuar, në veçanti, se përpunuesi duhet të veprojë vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit. Përpunuesi duhet të marrë në konsideratë parimin e mbrojtjes së të dhënave me anë të hartimit dhe parazgjedhjes.
- (56) Me qëllim që të provohet përputhshmëria me këtë Direktivë, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të mbajë regjistra për aktivitetet përpunuese në përgjegjësi të tij. Çdo kontrollues dhe përpunues është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetin mbikëqyrës dhe t'i vërë në dispozicion me kërkesë këto të dhëna, në mënyrë që kjo t'i shërbejë monitorimit të operacioneve të përpunimit. Kontrolluesi ose përpunuesi që përpunon të dhënat personale në sisteme përpunimi jo të automatizuara duhet të zbatojë metoda efektive të vërtetimit të ligjshmërisë së përpunimit, duke bërë të mundur vetëmonitorimin dhe sigurinë e integritetit dhe sigurisë së të dhënave, si enkriptimi dhe forma të tjera të regjistrave.
- (57) Regjistrat duhet të mbahen të paktën për operacione në sistemet e përpunimit të automatizuara, siç janë mbledhja, ndryshimi, konsultimi, zbulimi, duke përfshirë transferimet, kombinimin apo fshirjet. Identifikimi i personit që ka konsultuar apo nxjerrë të dhënat personale duhet të regjistrohet, dhe nga ky identifikim mund të bëhet i mundur arsyetimi i operacioneve të përpunimit. Regjistrat duhet të përdoren vetëm për verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit, vetëmonitorimit, për të siguruar integritetin dhe sigurinë e të dhënave dhe procedimet penale. Vetëvlerësimi përfshin gjithashtu procedurat e brendshme disiplinore të autoriteteve kompetente.
- (58) Me qëllim që të vërtetohet përputhshmëria me këtë Direktivë dhe të sigurohet mbrojtja e të dhënave personale kur operacionet e përpunimit mund të rezultojnë në një rrezik të lartë të të drejtave dhe lirive të personave fizikë, kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, për të vlerësuar veçanërisht, origjinën, natyrën, veçantinë dhe seriozitetin e rrezikut. Vlerësimet e ndikimit duhet të mbulojnë sistemet dhe proceset përkatëse të operacioneve të përpunimit, por jo raste të veçanta.

- (59) Me qëllim që të sigurohet mbrojtja efikase e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, kontrolluesi apo përpunuesi duhet të konsultohen me autoritetin mbikëqyrës, në raste të caktuara, përpara përpunimit.
- (60) Me qëllim që të ruhet siguria dhe të shmanget përpunimi në kundërshtim me këtë Direktivë, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të vlerësojë rreziqet që lidhen me përpunimin dhe të zbatojë masat për të lehtësuar këto rreziqe, si nëpërmjet enkriptimit. Këto masa duhet të garantojnë një nivel të përshtatshëm të sigurisë, duke përfshirë konfidencialitetin, duke marrë parasysh gjendjen e teknikës dhe shpenzimet e zbatimit në lidhje me rreziqet dhe natyrën e të dhënave personale që duhet të mbrohen. Në vlerësimin e rrezikut të sigurisë së të dhënave, duhet t'iu kushtohet vëmendje rreziqeve që paraqiten nga përpunimi i të dhënave personale, si asgjësimi aksidental ose i paligjshëm, humbja, ndryshimi, deklarimi i paautorizuar ose aksesit të të dhënave personale të transmetuara, ruajtura ose përpunuara, që mund të çojnë konkretisht në dëm fizik, material ose jomaterial. Kontrolluesi dhe përpunuesi duhet të sigurojnë se përpunimi i të dhënave personale nuk kryhet nga persona të paautorizuar.
- (61) Një shkelje e të dhënave personale, nëse nuk trajtohet në një mënyrë të përshtatshme dhe në kohë, mund të rezultojë në dëm fizik, material dhe jomaterial për personat fizikë, si humbja e kontrollit mbi të dhënave të tyre personale ose kufizimi i të drejtave të tyre, diskriminimi, vjedhje identiteti ose mashtrimi, humbje financiare, anulim i paautorizuar i pseudonimizimit, dëmi për reputacionin, humbja e konfidencialitetit të të dhënave personale të mbrojtura nga sekretet profesional ose një disavantazh tjetër serioz ekonomik ose social për personin fizik përkatës. Si rrjedhojë, menjëherë sapo kontrolluesi vjen në dijeni që ka ndodhur një shkelje e të dhënave personale, kontrolluesi duhet të njoftojë për shkeljen e të dhënave personale autoritetin mbikëqyrës pa vonesë të panevojshme dhe sipas rastit jo më vonë se 72 orë pas marrjes dijeni të saj, përveç kur kontrolluesi është në gjendje të provojë, në pajtim me parimin e përgjegjshmërisë, që shkelja e të dhënave personale nuk mund të rezultojë në një rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë. Nëse një njoftim i tillë nuk mund të arrihet brenda 72 orëve, shkaqet e vonesës duhet të shoqërojnë njoftimin dhe informacioni mund të jepet me pjesë pa vonesa të panevojshme të mëtejshme.
- (62) Kontrolluesi duhet t'i komunikojë subjektit të të dhënave shkeljen e të dhënave personale, pa vonesë të panevojshme, nëse shkelja e të dhënave personale ka gjasa të rezultojë në një rrezik të madh për të drejtat dhe liritë e personit fizik me qëllim që t'i mundësojë atij/asaj të marrë masat e nevojshme parandaluese. Komunikimi duhet të përshkruajë natyrën e shkeljes së të dhënave personale si dhe rekomandimet për personin fizik përkatës, me qëllim zbutjen e efekteve negative të mundshme. Një komunikim i tillë me subjektet e të dhënave duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin mbikëqyrës, duke respektuar udhëzimet e tij ose të autoriteteve të tjerë përkatës si autoritetet e zbatimit të ligjit. Për shembull, nevoja për të zbutur një rrezik të menjëhershëm dëmtimi do të kërkonte komunikimin e menjëhershëm me subjektin e të dhënave, ndërsa nevoja për të zbatuar masat e përshtatshme ndaj shkeljes së ngjashme ose të vazhdueshme të të dhënave personale mund të justifikojë një afat më të gjatë komunikimi. Kur shmangia e pengimit të hetimeve apo procedurave zyrtare ose ligjore, duke shmangur paragjykimet për parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, mbrojtjen e sigurisë publike dhe kombëtare apo mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve nuk mund të arrihet duke vonuar apo kufizuar komunikimin e shkeljes së të dhënave personale të personit fizik në fjalë, ky komunikim mund të mos kryet në rrethana të jashtëzakonshme.
- (63) Kontrolluesi duhet të caktojë një person i cili do të asistojë në monitorimin e përputhjes së brendshme me dispozitat e miratuara në bazë të kësaj Direktive, përveç se kur një Shtet Anëtar vendos të veprojë në kapacitetin e tij gjyqësor, duke përjashtuar gjykatat dhe autoritetet e pavarura gjyqësore. Ai person mund të jetë anëtar i stafit ekzistues të kontrolluesit që ka marrë trajnim të posaçëm në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave me qëllim përthithjen e njohurive të specializuara në atë fushë. Niveli i nevojshëm i ekspertizës duhet të përcaktohet veçanërisht sipas operacioneve të përpunimit të të dhënave të kryera dhe mbrojtjen e kërkuar për të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesi ose përpunuesi. Puna e tij/saj mund të kryhet me kohë të plotë ose të pjesshme. Një punonjës i mbrojtjes së të dhënave mund të jetë caktuar së bashku nga disa kontrollues, duke pasur parasysh strukturën organizative dhe madhësinë, për shembull në rastin e burimeve të përbashkëta në njësitë qendrore. Ky person mund të caktohet në pozicione të ndryshme brenda strukturës së kontrolluesve përkatës. Ai person duhet të ndihmojë kontrolluesin dhe punonjësit e përpunimit të të dhënave personale duke informuar dhe këshilluar lidhur me përputhshmërinë e detyrimeve të caktuara për mbrojtjen e të dhënave. Këta punonjës të mbrojtjes së të dhënave duhet të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e tyre në një mënyrë të pavarur në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar.
- (64) Shtetet Anëtare duhet të garantojnë se transferimi në një vend të tretë apo organizatë ndërkombëtare mund të kryhet vetëm nëse është i nevojshëm për parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike

dhe se sipas kësaj Direktive kontrolluesi në vendin e tretë apo nga organizata ndërkombëtare është një autoritet kompetent. Transferimi duhet të kryhet vetëm nga autoritetet kompetente që veprojnë si kontrollues, përveç se kur përpunuesit janë udhëzuar shprehimisht për të transferuar të dhëna në emër të kontrolluesve. Një transferim i tillë mund të ndodhë kur Komisioni ka vendosur se një vend i tretë apo një organizatë ndërkombëtare ofron një nivel të përshtatshëm për mbrojtjen e të dhënave, duke parashikuar sigurinë e nevojshme ose kur zbatohen përjashtime për situata të caktuara. Kur të dhënat personale transferohen nga Bashkimi tek kontrolluesit ose përpunuesit ose marrës të tjerë në vende të treta ose tek organizatat ndërkombëtare, niveli i mbrojtjes së personave fizikë i siguruar brenda Bashkimit nga kjo Direktivë nuk duhet të prishet, duke përfshirë në rastet e transferimeve transit të të dhënave personale nga vendi i tretë ose organizata ndërkombëtare te kontrolluesit, përpunuesit në të njëjtin ose në një vend të tretë apo organizatë ndërkombëtare.

- (65) Kur të dhënat personale transferohen nga një Shtet Anëtar te vendet e treta ose tek organizatat ndërkombëtare, një transferim i tillë duhet në parim të kryhet vetëm pasi Shteti Anëtar të japë autorizimin për transferimin. Interesat e bashkëpunimit efikas të zbatimit të ligjit kërkojnë që kur natyra e një kërcënimi ndaj sigurisë publike të një Shteti Anëtar ose një vendi të tretë ose interesave thelbësore të një Shteti Anëtar është aq i menjëhershëm sa të bëjë të pamundur marrjen e autorizimit paraprak në kohë, autoriteti kompetent duhet të jetë në gjendje të transferojë të dhënat përkatëse personale në vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare në fjalë pa autorizim paraprak. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë kushte specifike në lidhje me transferimin që do t'i komunikohen vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare. Transferimet e mëvonshme të të dhënave personale duhet të kryhet nëpërmjet autorizimit paraprak nga autoriteti kompetent që ka kryer transferimin origjinal. Kur vendoset për një kërkesë për autorizimin e një transferimi të mëparshëm, autoriteti kompetent që ka kryer transferimin origjinal duhet të marrë në konsideratë të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë seriozitetin e veprës penale, kushtet specifike të cilave iu nënshtrohen, dhe qëllimin për të cilat transferoheshin fillimisht, natyrën dhe kushtet e ekzekutimit të dënimit penal, si dhe nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në vendin e tretë ose një organizatë ndërkombëtare ku transferohen të dhënat personale. Autoriteti kompetent që ka kryer transferimin origjinal duhet të jetë në gjendje për transferimin transit në kushte të caktuara. Të tilla kushte specifike mund të përshkruhen, për shembull, në administrimin e kodeve.
- (66) Komisioni mund të vendosë, dhe vendimi të ketë efekt për të gjithë Bashkimin, që një vend i tretë, një territor ose një sektor i përcaktuar brenda një vendi të tretë, ose një organizatë ndërkombëtare, ofron një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje të të dhënave, duke parashikuar kështu siguri dhe njëtrajtshmëri juridike në të gjithë Bashkimin, në lidhje me vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare që konsiderohet të ofrojë një nivel të tillë mbrojtjeje. Në këto raste, transferimet e të dhënave personale në atë vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare mund të ndodhin pa nevojën e marrjes së autorizimeve të mëtejshme, përveç se kur një Shtet tjetër Anëtar nga ku janë marrë të dhënat duhet të japë autorizimin për transferimin.
- (67) Në përputhje me vlerat themelore në të cilat mbështetet Bashkimi, konkretisht mbrojtja e të drejtave të njeriut, Komisioni, në vlerësimin e tij për një vend të tretë ose për një territor apo sektor të përcaktuar brenda një vendi të tretë, duhet të marrë parasysh sidomos se si vendi i tretë respekton shtetin ligjor, aksesin në drejtësi, si dhe normat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ligjin e tij të përgjithshëm dhe sektorial, duke përfshirë legjislacionin në lidhje me sigurinë publike, mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, si dhe sektorin publik dhe të drejtën penale. Miratimi i një vendimi përshtatshmërie në lidhje me një territor ose sektor të posaçëm në një vend të tretë duhet të marrë parasysh kritere të qarta dhe objektive, si aktivitetet specifike të përpunimit dhe objektin e standardeve ligjore të zbatueshme dhe legjislacionin në fuqi në vendin e tretë. Vendi i tretë duhet të ofrojë garanci që sigurojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes thelbësisht të barasvlershëm me ata që është i siguruar brenda Bashkimit, veçanërisht kur të dhënat personale përpunohen në një ose disa sektorë specifike. Veçanërisht, vendi i tretë duhet të garantojë mbikëqyrje të efektshme dhe të pavarur të mbrojtjes së të dhënave dhe duhet të parashikojë mekanizmat e bashkëpunimit me autoritetet e mbrojtjes së të dhënave të Shteteve Anëtare dhe subjektet e të dhënave duhet të pajisen me të drejta efektive dhe të zbatueshme dhe të drejtë ankimi administrativ dhe gjyqësor të efektshëm.
- (68) Përveç angazhimeve ndërkombëtare që ka marrë përsipër vendi i tretë ose organizata ndërkombëtare, Komisioni duhet të marrë parasysh detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja e vendit të tretë ose e organizatës ndërkombëtare në sisteme shumëpalëshe ose rajonale veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe zbatimin e këtyre detyrimeve. Veçanërisht, duhet të merret parasysh aderimi i vendit të tretë në Konventën e Këshillit të Evropës të datës 28 janar 1981 për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollin e saj Shtesë. Komisioni duhet të konsultohet

me Bordin Evropian të të Dhënave Personale ngritur sipas Rregullores (BE) 2016/679 ('Bordi') gjatë vlerësimit të nivelit të mbrojtjes në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare. Komisioni duhet të marrë në konsideratë çdo vendim të Komisionit miratuar në përputhje me nenin 45 të Rregullores (BE) 2016/679.

- (69) Komisioni duhet të monitorojë funksionimin e vendimeve për nivelin e mbrojtjes në vend të tretë, territor, sektor i posaçëm brenda një vendi të tretë ose organizatë ndërkombëtare. Në vendimet e tij për përshtatshmërinë, Komisioni duhet të parashikojë një mekanizëm të rishikimit periodik për funksionimin e tyre. Ky rishikim periodik duhet të kryhet në konsultim me vendin e tretë ose të organizatës ndërkombëtare në fjalë dhe të marrë parasysh të gjitha zhvillimet në vendin e tretë apo organizatën ndërkombëtare.
- (70) Komisioni mund të njohë që një vend i tretë, një territor apo sektor i posaçëm brenda një vendi të tretë ose një organizatë ndërkombëtare nuk vazhdon të garantojë nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave. Për pasojë, transferimi i të dhënave personale në atë vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare duhet të ndalohej, përveç kur plotësohen kërkesat e kësaj Direktive në lidhje me transferimet që u nënshtrohen garancive të përshtatshme, duke përfshirë rregullat detyruese të brendshme dhe shmangiet në situata të caktuara. Në këtë rast, duhet të parashikohen konsultime ndërmjet Komisionit dhe këtyre vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare. Komisioni, në kohën e duhur, duhet të informojë vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare për shkaqet dhe të futet në bisedime me qëllim korrigjimin e situatës.
- (71) Transferimet e bëra në mungesë të një vendimi për përshtatshmërinë lejohen, vetëm nëse janë marrë masat e përshtatshme sipas një instrumenti ligjërishit detyrues, i cili siguron mbrojtjen e të dhënave personale ose kur kontrolluesi ka vlerësuar të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me transferimin e të dhënave dhe në bazë të saj vlerëson se ekzistojnë masa mbrojtëse të përshtatshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Të tillë instrumente ligjërishit detyrues mund të jenë, për shembull, marrëveshjet dypalëshe ligjërishit detyruese që janë lidhur ndërmjet Shteteve Anëtare dhe janë zbatuar në rendin e tyre ligjor dhe që mund të zbatohen nga subjektet e të dhënave, duke siguruar përputhshmërinë me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtat e subjekteve të të drejtave, duke përfshirë të drejtën e ankimit administrativ ose gjyqësor. Kontrolluesi duhet të marrë në konsideratë marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet Europol apo Eurojust dhe vendeve të treta që lejojnë shkëmbimin e të dhënave personale gjatë kryerjes së vlerësimit të të gjithë rrethanave lidhur me transferimin e të dhënave. Kontrolluesi duhet të marrë në konsideratë faktin se transferimi i të dhënave personale duhet të jetë objekti i detyrimeve të konfidencialitetit dhe parimit të specifikimit, duke siguruar se të dhënat nuk do të përpunohen për qëllime të tjera nga qëllimet e transferimit. Për më tepër, kontrolluesi duhet të marrë në konsideratë se të dhënat personale nuk do të përdoren për të kërkuar, dhënë apo zbatuar një dënim me vdekje apo çdo formë trajtimi çnjerëzor. Ndërsa këto kushte mund të konsiderohen si masat e nevojshme për të lejuar transferimin e të dhënave, kontrolluesi mund të kërkojë masa të tjera shtesë.
- (72) Në mungesë të një vendimi për përshtatshmërinë ose të garancive të përshtatshme, një transferim ose një grup transferimesh kryhet në raste të veçanta, nëse është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave ose të një person tjetër apo për të garantuar interesat legjitime të subjektit të të drejtave kur e parashikon legjislacioni i Shtetit Anëtar që transferon të dhënat personale; për parandalimin e një kërcënimi të menjëhershëm dhe serioz për sigurinë publike të një Shteti Anëtar apo një vendi të tretë; në rast individual me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve për rendin publik; apo një çështje individuale për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore. Këto shmangie duhet të interpretohen në mënyrë kufizuese dhe nuk duhet të lejojnë transferime të shpeshta, masive dhe strukturore të të dhënave personale ose transferime në shkallë të gjerë të të dhënave, por duhet të kufizohen në të dhënat që janë të nevojshme. Transferime të tilla duhet të dokumentohen dhe duhet të vihen në dispozicion të autoritetit mbikëqyrës sipas kërkesës për të monitoruar ligjshmërinë e transferimit.
- (73) Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare zbatojnë marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe në fuqi, të lidhura me vendet e treta në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet penale dhe bashkëpunimin e policisë, për shkëmbimin e informacionit përkatës, për t'i lejuar që të kryejnë detyrat e caktuara ligjërishit. Në parim, kjo ndodh nëpërmjet, ose të paktën me bashkëpunimin e autoriteteve kompetente në vendet e treta për qëllime të kësaj Direktive, ndonjëherë edhe në mungesë të marrëveshjes ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe. Megjithatë, në raste individuale të veçanta, procedurat e rregullta lidhur me kontaktimin e autoritetit të tillë në një vend të tretë mund të jetë jo efektive ose e pa përshtatshme, veçanërisht pasi transferimi mund të mos jetë kryer në kohën e duhur, ose pasi autoriteti në vendin e tretë nuk respekton sundimin e ligjit apo normat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në mënyrë që autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të mund të vendosin të transferojnë të dhënat personale drejtpërdrejt te marrësit e caktuar në vendet e treta. Ky mund të jetë rasti kur transferimi i të dhënave personale është i nevojshëm urgjentisht për të shpëtuar jetën e një personi që është në rrezik për t'u bërë viktimë e një veprë penale apo në interes të kryerjes së menjëhershme të një krimi, duke përfshirë terrorizmin.

Edhe nëse një transferim i tillë ndërmjet autoriteteve kompetente dhe marrësve të vendosur në vende të treta duhet të ndodhë vetëm në raste të veçanta individuale, kjo Direktivë duhet të parashikojë kushtet për të rregulluar këto raste. Këto dispozita nuk duhet të konsiderohen cenime të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet penale dhe bashkëpunimin policor. Këto rregulla zbatohen në plotësim të rregullave të tjera të kësaj Direktive, në veçanti ato për ligjshmërinë e përpunimit dhe Kreun V.

- (74) Nëse të dhënat personale dalin jashtë kufijve, kjo mund të shkaktojë një rrezik më të madh në lidhje me aftësinë e personave fizikë që të ushtrojnë të drejtat për mbrojtjen e të dhënave veçanërisht për t'u mbrojtur ndaj përdorimit ose deklarimit të paligjshëm të atij informacioni. Në të njëjtën kohë, autoritetet mbikëqyrëse mund të konstatojnë që ato nuk janë në gjendje të ndjekin ankimet ose të zhvillojnë hetime në lidhje me aktivitetet jashtë kufijve të tyre. Përpyekjet e tyre për të punuar së bashku në kontekstin ndërkufitar mund të pengohen gjithashtu nga kompetenca të pamjaftueshme parandaluese ose kompensuese dhe regjimet juridike të papërputhshme. Kështu, është e nevojshme të nxitet bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të mbrojtjes së të dhënave për të ndihmuar shkëmbimin e informacionit me homologët e tyre ndërkombëtarë.
- (75) Themelimi i autoriteteve mbikëqyrëse në Shtetet Anëtare, të autorizuara për të përmbushur detyrat e tyre dhe ushtruar kompetencat e tyre me pavarësi të plotë, është një komponent thelbësor i mbrojtjes së personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të monitorojnë zbatimin e dispozitave të miratuara në përputhje me këtë Direktivë dhe të kontribuojnë në zbatimin e saj të vazhdueshëm në të gjithë Bashkimin me qëllim mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale. Kështu, autoritetet mbikëqyrëse duhet të bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe Komisionin.
- (76) Shtetet Anëtare mund t'i besojnë një autoriteti mbikëqyrës të ngritur sipas Rregullores (BE)(EU)2016/679 me përgjegjësinë e kryerjes së detyrave nga autoritetet kombëtare mbikëqyrëse të krijuar sipas kësaj Direktive.
- (77) Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të ngrenë më shumë se një autoritet mbikëqyrës për të reflektuar strukturën e tyre kushtetuese, organizative dhe administrative. Çdo autoritet mbikëqyrës duhet të pajiset me burimet financiare dhe njerëzore, mjediset dhe infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e efektshme të detyrave të tij, duke përfshirë ato në lidhje me ndihmën e ndërsjellë dhe bashkëpunimin me autoritetet e tjerë mbikëqyrës në të gjithë Bashkimin. Secili autoritet mbikëqyrës duhet të ketë një buxhet të veçantë, publik dhe vjetor, që mund të jetë pjesë e buxhetit të përgjithshëm shtetëror ose kombëtar.
- (78) Pavarësia e autoriteteve mbikëqyrëse nuk duhet të nënkuptojë që autoritetet mbikëqyrëse nuk mund t'u nënshtrohen mekanizmave të kontrollit ose monitorimit në lidhje me shpenzimet e tyre financiare, kur ky kontroll financiar nuk ndikon pavarësinë e tyre.
- (79) Kushtet e përgjithshme për anëtarin ose anëtarët e autoritetit mbikëqyrës duhet të parashikohen me ligj në çdo Shtet Anëtar dhe duhet veçanërisht të parashikojë që ata anëtarë të njihen nëpërmjet një procedure transparente, nga parlamenti, qeveria ose kreu i Shtetit të Shtetit Anëtar sipas një propozimi nga qeveria, një anëtar i qeverisë, parlamenti ose një dhomë e parlamentit ose nga një organ i pavarur i ngarkuar sipas ligjit të Shtetit Anëtar. Me qëllim që të garantohet pavarësia e autoritetit mbikëqyrës, anëtari ose anëtarët duhet të veprojnë me integritet, të kufizohen ndaj çdo veprimi që nuk është në pajtim me detyrat e tyre dhe, gjatë mandatit të detyrës, nuk duhet të angazhohen në aktivitete të papërshtatshme, fitimprurëse ose jo. Me qëllim sigurimin e pavarësisë, autoriteti mbikëqyrës duhet të ketë personelin e tij të zgjedhur nga autoriteti mbikëqyrës ose një organ i pavarur i ngritur sipas ligjit të Shtetit Anëtar.
- (80) Ndërsa kjo Direktivë zbatohet për veprimtarinë e gjykatave të brendshme dhe autoritetet e tjera gjyqësore, kompetenca e autoriteteve mbikëqyrëse nuk duhet të mbulojë përpunimin e të dhënave personale kur gjykatat janë duke vepruar në kapacitetin e tyre gjyqësor, me qëllim garantimin e pavarësisë së gjyqtarëve në kryerjen e detyrave të tyre. Ky përjashtim duhet të kufizohet në aktivitetet gjyqësore në çështjet e gjykatave dhe nuk duhet të zbatohet për aktivitete të tjera ku gjyqtarët mund të përfshihen në përputhje me ligjin e Shtetit Anëtar. Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të parashikojnë se kompetenca e autoritetit mbikëqyrës nuk përfshin përpunimin e të dhënave personale të autoriteteve të pavarura gjyqësore kur veprojnë në kapacitetin e tyre gjyqësor, për shembull Prokuroria e Përgjithshme. Në çdo rast, përputhshmëria me rregullat e kësaj Direktive nga gjykatat dhe autoritetet e pavarura gjyqësore është subjekt i mbikëqyrjes së pavarur në përputhje me nenin 8(3) të Kartës.
- (81) Çdo autoritet mbikëqyrës duhet të trajtojë ankimet e paraqitura nga subjektet e të dhënave, të hetojë çështjen dhe t'ia transmetojë autoritetit kompetent mbikëqyrës. Hetimi që pason një ankim duhet të kryhet, duke iu nënshtruar rishikimit gjyqësor, në masën që është i përshtatshëm në një çështje specifike. Autoriteti mbikëqyrës duhet të njoftojë subjektin e të dhënave në lidhje me përparimin dhe rezultatin e ankimit, brenda një afati të arsyeshëm. Nëse çështja kërkon hetime të mëtejshme ose bashkërendim me një autoritet tjetër mbikëqyrës, subjektit të të dhënave duhet t'i jepet informacioni i ndërmjetëm.
- (82) Me qëllim që të garantohet monitorimi dhe ekzekutimi i njëtrajtshëm i kësaj Direktive në të gjithë Bashkimin, në përputhje me TFBE, sipas interpretimit të Gjykatës së Drejtësisë, autoritetet mbikëqyrëse të çdo Shteti Anëtar duhet të kenë të njëjtat detyra dhe kompetenca efektive, duke përfshirë kompetencat e hetimit, kompetencat korrigjuese dhe këshillimore, që përbëjnë mjete të nevojshme për të kryer këto detyra. Megjithatë kompetencat e tyre nuk duhet të ndërhyjnë në rregullat e caktuara për procedimet penale, duke përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale apo pavarësinë e sistemit gjyqësor. Në bazë të ligjit të Shtetit Anëtar, autoritetet mbikëqyrëse duhet të kenë

kompetencën për të sjellë shkeljet e kësaj Rregulloreje në vëmendje të autoriteteve gjyqësore dhe të përfshihen në procedime gjyqësore duke mos cenuar kompetencat e autoriteteve të prokurorisë. Kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse duhet të ushtrohen në pajtim me garancitë e përshtatshme procedurale të përcaktuara në të drejtën e Bashkimit dhe Shtetit Anëtar, në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Veçanërisht, secila masë duhet të jetë e përshtatshme, e nevojshme dhe proporcionale, duke pasur parasysh përputhshmërinë me këtë Direktivë, duke marrë në konsideratë rrethanat në çdo rast konkret, respektimin e së drejtës së çdo personi për t'u dëgjuar përpara marrjes së çdo mase individuale në dëm të tij dhe të mënjanojë shpenzimet e tepërta dhe papërshtatshmëritë e tepërta për personat e interesuar. Kompetencat hetimore në lidhje me aksesin në mjedis duhet të ushtrohen në pajtim me kërkesat specifike në të drejtën procedurale të Shtetit Anëtar, si kërkesa për të marrë paraprakisht autorizim gjyqësor. Miratimi i një vendimi ligjërish detyruës nënkupton që ai mund të bëhet shkak për rishikim gjyqësor në Shtetin Anëtar të autoritetit mbikëqyrës që ka miratuar vendimin.

- (83) Autoritetet mbikëqyrëse duhet të asistojnë njëri-tjetrin në përmbushjen e detyrave të tyre dhe të japin asistencë, në lidhje me sigurimin e zbatimit dhe aplikimit të njëtrajtshëm të kësaj Direktive.
- (84) Bordi duhet të kontribuojë në aplikimin e njëtrajtshëm të kësaj Direktive në të gjithë Bashkimin, duke përfshirë këshillimin e Komisionit dhe duke nxitur bashkëpunimin e autoriteteve mbikëqyrëse në të gjithë Bashkimin.
- (85) Çdo subjekt të dhënash duhet të ketë të drejtën të paraqesë një ankesë tek një autoritet i caktuar mbikëqyrës dhe të ketë një mjet mbrojtjeje të efektshëm gjyqësor, sipas nenit 47 të kartës, nëse subjekti i të dhënave është i mendimit që të drejtat e tij/saj, sipas kësaj Direktive janë shkelur ose nëse autoriteti mbikëqyrës nuk vepron në lidhje me një ankim, e refuzon pjesërisht ose tërësisht ose e pushon ankimin apo nuk vepron nëse një veprim i tillë është i nevojshëm për të mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave. Hetimi që pason një ankim duhet të kryhet, duke iu nënshtruar rishikimit gjyqësor, në masën që është i përshtatshëm në një çështje specifike. Autoriteti mbikëqyrës duhet të njoftojë subjektin e të dhënave në lidhje me përparimin dhe rezultatin e ankimit, brenda një afati të arsyeshëm. Nëse çështja kërkon hetime të mëtejshme ose bashkërendim me një autoritet tjetër mbikëqyrës, subjektit të të dhënave duhet t'i jepet informacion i ndërmjetëm. Me qëllim që të lehtësojë paraqitjen e ankimeve, çdo autoritet mbikëqyrës duhet të marrë masa të tilla si parashikimi i një formulari për paraqitjen e kërkesës që mund të plotësohet edhe në mënyrë elektronike, pa përjashtuar mjete të tjera komunikimi.
- (86) Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e një mjeti të efektshëm gjyqësor mbrojtës përpara gjykatës së brendshme kompetente ndaj një vendimi të një autoriteti mbikëqyrës që prodhon efekte ligjore për atë person. Një vendim i tillë ka të bëjë veçanërisht me ushtrimin e kompetencave hetimore, korrigjuese dhe autorizuese nga autoriteti mbikëqyrës, refuzimin apo pushimin e ankimit. Megjithatë, e drejta për një mjet të efektshëm gjyqësor mbrojtës nuk përfshin masat e marra nga autoritetet mbikëqyrëse, që nuk janë ligjërish detyruese, si mendimet e nxjerra ose këshillimi i dhënë nga autoriteti mbikëqyrës. Gjykimet ndaj një autoriteti mbikëqyrës duhet të fillojnë para gjykatave të Shtetit Anëtar ku është ngritur autoriteti mbikëqyrës dhe duhet të zhvillohen në pajtim me ligjin procedural të Shtetit Anëtar. Këto gjykata duhet të ushtrojnë juridiksion të plotë, duke përfshirë juridiksionin për të shqyrtuar të gjitha çështjet e faktit dhe ligjit që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjen e ngritur para tyre.
- (87) Nëse një subjekt të dhënash është i mendimit që të drejtat e tij/ saj, sipas kësaj Direktive, janë shkelur, ai/ajo duhet të ketë të drejtën të autorizojë një organ që është ngritur në pajtim me ligjin e një Shteti Anëtar, që ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të subjekteve të të dhënave në fushën e të dhënave personale, për të paraqitur një ankim në emër të tij/saj tek një autoritet mbikëqyrës dhe të ushtrojë të drejtën nëpërmjet një mjeti gjyqësor mbrojtës në emër të subjekteve të të dhënave. E drejta e përfaqësimit të subjektit të të dhënave nuk duhet të cenohet të drejtën procedurale të Shtetit Anëtar që mund të kërkojë përfaqësimin e detyrueshëm me avokat të subjektit në gjykatat e brendshme, sipas përcaktimit në Direktivën e Këshillit 77/249/EEC ⁽¹⁾.

- (88) Kontrolluesi, ose çdo autoritet tjetër kompetent sipas ligjit të Shtetit Anëtar, duhet të kompensojë çdo dëm që mund të pësojë një person si rezultat i përpunimit që shkel dispozitat e kësaj Direktive. Koncepti i dëmit duhet të interpretohet më gjerë nën dritën e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë, në mënyrë të tillë që të reflektojë tërësisht objektivat e kësaj Direktive. Kjo nuk përjashton pretendimet e tjera për dëme që rrjedhin nga shkelja e rregullave të tjera të së drejtës së Bashkimit ose të Shtetit Anëtar. Përpunimi që është i paligjshëm ose që shkel këtë Direktivë përfshin edhe përpunimin që shkel aktet zbatuese që janë miratuar në pajtim me këtë Direktivë. Subjektet e të dhënave duhet të marrin kompensim të plotë dhe të efektshëm për dëmin që kanë pësuar.
- (89) Gjobat mund të vendosen për një person fizik ose juridik, të parashikuar nga e drejta publike ose private, që cenon këtë Direktivë. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen se gjobat e caktuara janë efektive, proporcionale dhe penguese, dhe duhet të marrin të gjitha masat për zbatimin e tyre.
- (90) Për të garantuar kushte të unifikuara për zbatimin e kësaj Direktive, kompetencat e zbatimit duhet t'i jepen Komisionit lidhur me nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes së ofruar nga një vend i tretë, një territor ose një sektor i posaçëm brenda atij vendi të tretë ose një organizate ndërkombëtare dhe formën dhe procedurat për ndihmën e ndërsjellë dhe masat për shkëmbimin e informacionit me mjete elektronike ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, dhe ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe bordit. Këto kompetenca duhet të ushtrohen në pajtim me Rregulloren (BE) Nr182/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁽²⁾.
- (91) Procedura e shqyrtimit duhet të përdoret për miratimin e akteve zbatuese për nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes së ofruar nga një vend i tretë, një territor ose një sektor i specifikuar brenda atij vendi të tretë ose një organizatë ndërkombëtare dhe formën dhe procedurat për ndihmën e ndërsjellë dhe masat për shkëmbimin e informacionit me mjete elektronike ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, dhe ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe bordit, duke pasur parasysh se këto akte kanë një fushëveprim të përgjithshëm.
- (92) Komisioni duhet të miratojë menjëherë akte të përshtatshme zbatimi, nëse provat e disponueshme tregojnë që një vend i tretë, një territor ose një sektor i caktuar brenda atij vendi të tretë ose një organizatë ndërkombëtare nuk garanton një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes dhe këtë e kërkojnë shkaqe të domosdoshme të urgjencës.
- (93) Meqenëse objektivat e kësaj Direktive, që janë mbrojtja e të drejtave dhe lirive të personave fizikë dhe në veçanti e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale dhe garantimi i shkëmbimit të lirë të të dhënave personale nga autoritetet kompetente brenda Bashkimit, nuk mund të arrihen në masën e mjaftueshme nga Shtetet Anëtare dhe, nga ana tjetër, për shkak të shkallës ose efekteve të veprimit, mund të arrihen më mirë në nivelin e Bashkimit, Bashkimi mund të miratojë masat në pajtim me parimin e subsidiaritetit sipas parashikimit në nenin 5 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE). Në pajtim me parimin e proporcionalitetit sipas parashikimit në këtë nen, kjo Direktivë nuk shkon tej asaj që është e nevojshme me qëllim që të arrihen këto objektiva.
- (94) Dispozitat specifike të akteve të Bashkimit, miratuar në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale dhe bashkëpunim policor, të cilat janë miratuar përpara hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, që rregullon përpunimin e të dhënave personale ndërmjet Shteteve Anëtare apo aksesin e autoriteteve të caktuara të Shteteve Anëtare për sisteme informacioni

(1) Direktiva e Këshillit 77/249/KEE e 22 marsit 1977 për të lehtësuar ushtrimin efektiv nga avokatët lidhur me lirinë për të ofruar shërbime (GZL78, 26.3.1977, fq.17).

(2) Rregullorja (BE) Nr. 182/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shkurtit 2011 për përcaktimin e rregullave dhe parimeve të përgjithshme për mekanizmat e kontrollit nga Shtetet Anëtare për ushtrimin e kompetencave zbatuese nga Komisioni (GZ L 55, 28.2.2011, fq. 13).

krijuar në përputhje me Traktatet, duhet të qëndrojnë të pacenuara, si për shembull dispozitat përkatëse lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me Vendimin e Këshillit 2008/615/JHA ⁽¹⁾, ose nenin 23 të Konventës mbi Ndihmën e Përbashkët në Çështje Penale ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian ⁽²⁾. Duke qenë se neni 8 i Kartës dhe neni 16 i TFBE-së kërkojnë që e drejta themelore për mbrojtjen e të dhënave personale të sigurohet në një mënyrë konsistente në të gjithë Bashkimin, Komisioni duhet të vlerësojë situatën lidhur me marrëdhënien ndërmjet kësaj Direktive dhe akteve të miratuara përpara datës së miratimit të kësaj Direktive, duke rregulluar përpunimin e të dhënave personale ndërmjet Shteteve Anëtare ose aksesin e autoriteteve të caktuara të Shteteve Anëtare në sistemet e informacionit krijuar në përputhje me Traktatet, për të vlerësuar nevojën e përputhshmërisë së këtyre dispozitave specifike me këtë Direktivë. Kur është e mundur, Komisioni mund të bëjë propozime për të siguruar rregulla ligjore të qëndrueshme lidhur me përpunimin e të dhënave personale.

- (95) Për të siguruar një mbrojtje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të të dhënave personale në Bashkim, marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga Shtetet Anëtare përpara hyrjes në fuqi të kësaj Direktive dhe të cilat janë në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit përpara asaj date do të qëndrojnë në fuqi deri në ndryshimin apo shfuqizimin e tyre.
- (96) Shtetet Anëtare kanë një periudhë jo më shumë se dy vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Direktive për të siguruar pajtueshmërinë. Përpunimi i filluar para kësaj date duhet të silltet në pajtim me këtë Direktivë brenda periudhës së dy viteve pasi kjo Direktivë të ketë hyrë në fuqi. Megjithatë kur një përpunim i tillë është në përputhje me të drejtën e Bashkimit, të zbatueshme përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, kërkesat e kësaj Direktive lidhur me këshillimin paraprak të autoritetit mbikëqyrës nuk duhet të zbatohen për operacionet përpunuese që janë bërë në atë datë duke qenë se ato kërkesa, nga vetë natyra e tyre, janë plotësuar përpara përpunimit. Kur Shtetet Anëtare përdorin periudhën më të gjatë të zbatimit, që kalon shtatë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, për të plotësuar detyrimet e hyrjes për sistemet e përpunimit automatike të vendosura përpara asaj date, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të vendosin metoda efektive për të demonstruar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave, për të bërë të mundur vetëmonitorimin dhe për të garantuar integritetin dhe sigurinë e të dhënave, si regjistrat apo forma të tjera regjistrimi.
- (97) Kjo Direktivë nuk cenon rregullat mbi luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, të parashikuara nga Direktiva 2011/93/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit ⁽³⁾.
- (98) Vendimi Kuadër 2008/977/JHA duhet të shfuqizohet.
- (99) Në përputhje me nenin 6a të Protokollit Nr. 21 për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, bashkëlidhur si shtojcë TBE-së dhe TFBE-së, Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk janë të detyruara të zbatojnë rregullat e përcaktuara në këtë Direktivë që lidhen me përpunimin e të dhënave personale nga Shtetet Anëtare gjatë kryerjes së aktiviteteve që janë në objektin e Kreut 4 ose Kreut 5 të Titullit V të Pjesës së Tretë të TFBE-së, ku Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk janë të detyruara të zbatojnë rregullat lidhur me format e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale apo bashkëpunimin policor që kërkon përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 16 të TFBE-së.
- (100) Në përputhje me nenin 2 dhe 2a të Protokollit Nr. 22 për qëndrimin e Danimarkës, bashkëlidhur si shtojcë TBE-së dhe TFBE-së, Danimarka nuk është e detyruar të zbatojë këtë Direktivë apo të jetë objekt i zbatimit që lidhet me përpunimin e të dhënave personale nga Shtetet Anëtare gjatë kryerjes së aktiviteteve që janë në objektin e Kreut 4 ose Kreut 5 të Titullit V të Pjesës së Tretë të TFBE-së. Duke qenë se kjo Direktivë bazohet mbi tërësinë e legjislacionit të Shengenit, në përputhje me Titullin V të Pjesës së Tretë të TFBE-së, Danimarka, në përputhje me nenin 4 të këtij Protokollit dhe brenda gjashtë muajve pasi Këshilli ka marrë vendimin për këtë Direktivë, vendos nëse do ta zbatojë atë në legjislacionin e saj të brendshëm.
- (101) Për sa i përket Islandës dhe Norvegjisë, kjo Direktivë përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit, sipas kuptimit të Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë për asociimin e këtyre të fundit me implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit ⁽⁴⁾.

(1) Vendim i Këshillit 2008/615/JHA i 23 qershorit 2008 mbi forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit dhe kriminalitetin ndërkufitar (GZL210,6.8.2008,fq.1).

(2) Akt i Këshillit i 29 majit 2000, ngritur në përputhje me nenin 34 të Traktatit mbi Bashkimin Evropian Konventa mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (GZ C 197, 12.7.2000, fq.1).

(3) Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 dhjetorit 2011 për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/68/JHA(GZL335,17.12.2011,fq.1).

(4) GZ L 176, 10.7.1999, fq. 36.

- (102) Për sa i përket Zvicrës, kjo Direktivë përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit, sipas kuptimit të Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për asociimin e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit ⁽¹⁾.
- (103) Për sa i përket Lihtenshtejnit, kjo Direktivë përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit, sipas kuptimit të Protokollit ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian, Konfederatës Zvicerane dhe Principatës së Lihtenshtejnit për aderimin e Principatës së Lihtenshtejnit në marrëveshjen ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetin Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për asociimin e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit ⁽²⁾.
- (104) Kjo Direktivë respekton të drejtat themelore dhe ndjek parimet e njohura nga Karta dhe TFBE, në veçanti të drejtën për jetë private dhe familjare, të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, të drejtën e zgjidhjes efikase dhe për gjykim të drejtë. Kufizimet mbi këto të drejta janë në pajtim me nenin 52 (1) të Kartës, pasi janë të nevojshme për të arritur objektivat e interesit të përgjithshëm të njohur nga Bashkimi dhe nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve.
- (105) Në përputhje me Deklaratën Politike të Përbashkët të Shteteve Anëtare dhe Komisionit, e datës 28 shtator 2011, për dokumentet shpjeguese, Shtetet Anëtare janë angazhuar të shoqërojnë, në raste të argumentuara, njoftimin për masat e tyre të transpozimit me një ose më shumë dokumente ku shpjegohet marrëdhënia ndërmjet komponentëve të direktivës dhe pjesëve përkatëse të masave kombëtare. Në lidhje me këtë Direktivë, ligjvënësi e konsideron transmetimin e këtyre dokumenteve si të justifikuar.
- (106) Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale këshillohet në përputhje me nenin 28(2) të Rregullores (KE) Nr. 45/2001 dhe shpreh mendimin e tij më 7 mars 2012⁽³⁾.
- (107) Kjo Direktivë nuk duhet të cenojë detyrimet e Shteteve Anëtare për të zbatuar ushtrimin e së drejtave të subjektit të të dhënave mbi informacionin, aksesin dhe korrigjimin apo fshirjen e të dhënave personale dhe kufizimin e përpunimit gjatë procedurave penale, dhe kufizimet e tyre në rregullat kombëtare mbi procedurën penale.

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Objekti dhe objektivat

1. Kjo Direktivë përcakton rregullat në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit apo ndjekjes penale të veprave penale apo ekzekutimin e vendimeve penale, duke përfshirë garancitë dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike.
2. Në përputhje me këtë Direktivë, Shtetet Anëtare duhet të:
 - (a) mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë dhe veçanërisht të drejtën e tyre për të mbrojtur të dhënat personale; dhe
 - (b) sigurojnë se shkëmbimi i të dhënave personale nga autoritetet kompetente brenda Bashkimit nuk kufizohet ose ndalohet për shkaqe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e personave fizikë për sa i takon përpunimit të të dhënave personale, kur një shkëmbim i tillë kërkohet nga legjislacioni i Bashkimit ose Shtetit Anëtar.

⁽¹⁾ GZ L 53, 27.2.2008, fq. 52.

⁽²⁾ GZ L 160, 18.6.2011, fq. 21.

⁽³⁾ GZ C 192, 30.6.2012, fq. 7.

3. Kjo Direktivë nuk ndalon Shtetet Anëtare të ofrojnë garanci më të mëdha se sa ato të parashikuar në këtë Direktivë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të subjektit të të drejtave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Direktivë zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllimet e përcaktuara në nenin 1(1).

2. Kjo Direktivë zbatohet për përpunimin e të dhënave personale plotësisht ose pjesërisht me mjete automatike dhe për përpunimin e ndryshëm me mjete automatike të të dhënave personale që janë pjesë e sistemit të skedimit apo që destinohen të jenë pjesë e sistemit të skedimit.

3. Kjo Direktivë nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale:

- (a) Në vazhdën e aktivitetit që del jashtë fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit;
- (b) Nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Direktive:

- (1) 'të dhëna personale' është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ('subjekt i të dhënave'); një person fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi si një emër, një numër identifikimi, të dhëna për vendndodhjen, një identifikues online ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik;
- (2) 'përpunim' është çdo operacion ose grup operacionesh që kryhen me të dhënat personale ose grupet e të dhënave personale, me mjete automatike ose jo, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi ndërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njëhësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi;
- (3) 'kufizimi i përpunimit' është shënjimi i të dhënave personale të ruajtura, me synim kufizimin e përpunimit të tyre në të ardhmen;
- (4) 'profilizimi' është çdo formë e përpunimit automatik të të dhënave personale, që konsiston në përdorimin e të dhënave personale për të vlerësuar aspektet personale në lidhje me një person fizik, veçanërisht për të analizuar ose parashikuar aspekte në lidhje me mbarëvajtjen e personit në punë, gjendjen ekonomike, shëndetin, preferencat personale, interesat, besueshmërinë, sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet e tij;
- (5) 'pseudonimizimi' është përpunimi i të dhënave personale në një mënyrë të tillë që të dhënat personale të mos vazhdojnë të lidhen me një subjekt të caktuar të të dhënave pa përdorimin e informacionit shtesë, me kusht që ky informacion shtesë të mbahet veçmas dhe t'u nënshtrohet masave teknike dhe organizative për të garantuar që të dhënat personale të mos i vishen një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm;
- (6) 'sistem skedimi' është një komplet i strukturuar të dhënash personale që janë të aksesueshme në pajtim me kriteret specifike, të centralizuara, decentralizuara ose të shpërndara mbi bazë funksionale ose gjeografike;
- (7) 'autoritet kompetent' është:
 - (a) çdo autoritet publik kompetent për parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garancitë dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike; ose
 - (b) çdo organ ose entitet i përcaktuar nga e drejta e Bashkimit për të ushtruar autoritet dhe fuqi publike, me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garancitë dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike.

- (8) 'kontrollues' është autoriteti kompetent, që vetëm ose së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale; nëse qëllimet dhe mjetet e këtij përpunimi përcaktohen nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar, kontrolluesi ose kriteret specifike për emërtimin e tij mund të parashikohen nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar;
- (9) 'përpunues' është një person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit;
- (10) 'marrës' është një person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër, të cilit i deklarohen të dhënat personale, qoftë palë e tretë ose jo. Megjithatë, autoritetet publike që mund të marrin të dhëna personale në kuadrin e një hetimi të veçantë në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar nuk konsiderohen si marrës; përpunimi i këtyre të dhënave nga autoritetet publike janë në pajtim me rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave sipas qëllimeve të përpunimit;
- (11) 'shkelje e të dhënave personale' është një shkelje e sigurisë që sjell asgjësimin, humbjen, ndryshimin, deklarimin e paautorizuar, aksidental ose të paligjshëm, ose aksesin të të dhënave personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara ndryshe;
- (12) 'të dhëna gjenetike' janë të dhënat personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të përfutuara të një personi fizik që jep informacion unik në lidhje me fiziologjinë ose shëndetin e atij personi fizik dhe që rezulton veçanërisht nga një analizë e një kampioni biologjik nga personi fizik në fjalë;
- (13) 'të dhëna biometrike' janë të dhënat personale që rezultojnë nga përpunimi specifik teknik në lidhje me karakteristikat fizike, fiziologjike ose të sjelljes së një personi fizik, që lejon ose konfirmon identifikimin unik të atij personi fizik, si imazhet pamore ose të dhënat daktiloskopike;
- (14) 'të dhënat në lidhje me shëndetin' janë të dhënat personale në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të një personi fizik, duke përfshirë dhënien e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, që tregon informacion në lidhje me gjendjen e tij ose të saj shëndetësore;
- (15) 'autoritet mbikëqyrës' është një autoritet publik i pavarur që është krijuar nga një Shtet Anëtar në përputhje me nenin 41;
- (16) 'organizatë ndërkombëtare' është një organizatë dhe organet e veta vartëse të rregulluara nga e drejta ndërkombëtare publike ose një organ tjetër që është i ngritur nga/ose në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë vendeve.

KREU II

Parimet

Neni 4

Parimet në lidhje me përpunimin e të dhënave personale

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të dhënat personale:
 - (a) përpunohen në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë;
 - (b) mbliidhen për qëllime të specifikuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk përpunohen më tej në një mënyrë që nuk është në përputhje me ato qëllime;
 - (c) të jenë të përshtatshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në lidhje me qëllimet për të cilën ato përpunohen;
 - (d) të jenë të sakta dhe, sipas rastit, të mbahen të përditësuara; duhet të merret çdo hap i arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta, duke pasur parasysh qëllimet për të cilat janë përpunuar, të fshihen ose të korrigjohen pa vonësë;
 - (e) të mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale;
 - (f) të përpunohen në një mënyrë që garanton siguri të përshtatshme të të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masat e përshtatshme teknike dhe organizative.

2. Përpunimi nga i njëjti kontrollues ose një tjetër për qëllimet e përcaktuara në nenin 1(1), përveç atij për të cilin janë mbledhur të dhënat personale, duhet të lejohen vetëm nëse:
 - (a) Kontrolluesi është i autorizuar për të përpunuar të dhënat personale për një qëllim tjetër nga ai për të cilin janë mbledhur, në përputhje me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar; dhe
 - (b) Përpunimi është i nevojshëm dhe proporcional me qëllimin e ndjekur në përputhje me të drejtën e Bashkimit apo Shtetit Anëtar.
3. Përpunimi nga i njëjti ose tjetër kontrollues mund të përfshijë arkivimin në interes publik, përdorim shkencor, statistikor ose historik për qëllimet e parashikuara në nenin 1(1) dhe parashikon masa të përshtatshme për të garantuar të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave.
4. Kontrolluesi është përgjegjës dhe në gjendje të demonstrojë përputhshmërinë me paragrafët 1,2 dhe 3.

Neni 5

Afatet kohore për arkivimin dhe rishikimin

Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë afatet kohore të përshtatshme për të garantuar fshirjen e të dhënave personale ose rishikim periodik të dhënave personale. Masat procedurale duhet të sigurojnë se këto afate kohore respektohen.

Neni 6

Dallimi ndërmjet kategorive të ndryshme të subjektit të të dhënave

Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë për kontrolluesin, kur është e mundur dhe për aq sa ka mundësi, bërjen e një dallimi të qartë ndërmjet të dhënave personale të kategorive të ndryshme të subjektit të të dhënave, si:

- (a) persona për të cilët ka arsye serioze për të besuar se kanë kryer ose janë duke kryer një vepër penale;
- (b) persona të dënuar për një vepër penale;
- (c) viktimat të një veprë penale apo persona për të cilët fakte të caktuara japin arsye për të besuar se ai/ajo mund të jenë viktimë të një veprë penale; dhe
- (d) palë të tjera të një veprë penale, si persona që mund të thirren për të dëshmuar në hetime lidhur me vepra penale ose procedurat penale, persona që mund të japin informacion mbi veprat penale, apo kontaktet apo bashkëpunues të personave të parashikuara në pikat (a) dhe (b).

Neni 7

Dallimi ndërmjet të dhënave personale dhe verifikimi i cilësisë së të dhënave personale

1. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë që të dhënat personale të bazuar në fakte të dallohen, sa më shumë të jetë e mundur, nga të dhënat personale të bazuara në vlerësime personale.
2. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet kompetente të marrin çdo hap të arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale të pasakta, të paplota dhe të pa përditësuara të mos transmetohen apo vihen në dispozicion. Për këtë arsye, çdo autoritet kompetent duhet të verifikojë cilësinë e të dhënave personale përpara se ato të transmetohen apo të vihen në dispozicion. Për sa kohë është e mundur, në të gjitha transmetimet e të dhënave personale, duhet të shtohet informacioni i nevojshëm që bën të mundur që autoriteti kompetent marrës të vlerësojë nivelin e saktësisë, plotësisë dhe besueshmërisë së të dhënave personale dhe masën në të cilën janë përditësuar.
3. Nëse rezulton se janë transmetuar të dhëna personale të gabuara, ose janë transmetuar në mënyrë të paligjshme, marrësi duhet të njoftojë pa vonesë. Në këtë rast, të dhënat personale duhet të korrigjohen ose fshihen, në përputhje me nenin 16.

*Neni 8***Ligjshmëria e përpunimit**

1. Shtetet Anëtare parashikojnë se përpunimi është i ligjshëm vetëm dhe në masën që zbatohet për kryerjen e një detyre nga autoriteti kompetent për qëllimet e parashikuara nga neni 1(1) dhe bazuar në të drejtën e Bashkimit apo Shtetit Anëtar.
2. Legjislacioni i Shteteve Anëtare që rregullon përpunimin brenda qëllimit të kësaj Direktive duhet të përcaktojë të paktën objektivat e përpunimit, të dhënat personale për t'u përpunuar dhe qëllimet e përpunimit.

*Neni 9***Kushte të veçanta përpunimi**

1. Të dhënat personale të mbledhura nga autoritetet kompetente për qëllimet e përcaktuara në nenin 1(1) nuk përpunohen për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 1(1) vetëm nëse një përpunim i tillë është parashikuar nga e drejta e Bashkimit apo Shtetit Anëtar. Kur të dhënat personale përpunohen për qëllime të tjera, zbatohet Rregullorja (BE)2016/679 vetëm nëse përpunimi kryhet për një aktivitet jashtë fushës së të drejtës së Bashkimit.
2. Kur autoritetet kompetente janë përcaktuar nga ligji i Shtetit Anëtar për të kryer detyra përveç atyre me qëllim të përcaktuar në nenin 1(1), zbatohet Rregullorja (BE) 2016/679 për këto qëllime, duke përfshirë qëllime arkivimi në interes publik, për qëllime të kërkimeve shkencore ose historike ose për qëllime statistikore, vetëm nëse përpunimi kryhet për një aktivitet jashtë sferës së të drejtës së Bashkimit.
3. Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë kushtet specifike për përpunimin, kur e drejta e Bashkimit apo Shtetit Anëtar për autoritetin kompetent transmetues, parashikon për autoritetin kompetent transmetues informimin e marrësit për këto të dhëna dhe kushtet dhe kërkesat për t'i zbatuar ato.
4. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë se autoriteti kompetent transmetues nuk duhet të zbatojë kushtet në përputhje me paragrafin 3 të marrësve në Shtete të tjera Anëtare apo agjenci, zyra dhe organe të krijuar në përputhje me Kapitujt 4 dhe 5 të Titullit V të TFBE-së përveç atyre të zbatueshme për transmetime të njëjta të të dhënave në Shtetin Anëtar të autoritetit kompetent transmetues.

*Neni 10***Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale**

Përpunimi i të dhënave personale që tregojnë origjinën racore ose etnike, bindjet fetare ose filozofike, anëtarësinë në sindikatat profesionale dhe përpunimi i të dhënave gjenetike, të dhënave biometrike për qëllimet e identifikimit të një personi fizik në mënyrë unike, të dhënat në lidhje me shëndetin ose të dhënat në lidhje me jetën seksuale ose orientimin seksual të një personi fizik mund të lejohen vetëm nëse është i nevojshëm, subjekt të masave të nevojshme për liritë dhe të drejtat e subjektit të të dhënave, dhe vetëm kur:

- (a) parashikohet nga e drejta e Bashkimit ose Shtetit Anëtar;
- (b) mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave apo një personi tjetër fizik; apo
- (c) kur përpunimi lidhet me të dhëna që janë bërë publike nga subjekti i të dhënave.

*Neni 11***Vendimmarrja e automatizuar individuale**

1. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë ndalimin e një vendimi të bazuar vetëm në një përpunim automatik, duke përfshirë profilizimin, që prodhon efekte ligjore në lidhje me subjektin e të dhënave ose e ndikon atë në mënyrë të ndjeshme, përveç rastit kur autorizohet nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi dhe që përcakton edhe masat e përshtatshme për të garantuar të drejtat dhe liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave, të paktën të drejtën për të realizuar ndërhyrjen manuale nga ana e kontrolluesit.

2. Vendimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni nuk bazohen në kategoritë e veçanta të të dhënave personale të përmendura në nenin 10, përveç kur masat e përshtatshme për të garantuar të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave janë në fuqi.

3. Profilizimi që rezulton në diskriminim ndaj personave fizikë mbi bazën e kategorive të veçanta të të dhënave personale të parashikuar në nenin 10 duhet të ndalohet në përputhje me të drejtën e Bashkimit.

KREU III

Të drejtat e subjektit të të dhënave

Neni 12

Komunikimi dhe modalitetet e ushtrimit të të drejtave të subjektit të të dhënave

1. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë se kontrolluesi merr masat e përshtatshme për të dhënë çdo informacion të referuar në nenin 13 dhe çdo komunikim sipas neneve 11,14 deri 18 dhe 31 në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që i nënshtrohen një formati konciz, transparent, të kuptueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të pastër. Informacioni jepet me çdo mjet të përshtatshëm, duke përfshirë mjetet elektronike. Si rregull i përgjithshëm, kontrolluesi duhet të japë informacionin në të njëjtën formë si kërkesa.

2. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë se kontrolluesi lehtëson ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave sipas neneve 11 dhe 14 deri 18.

3. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë se kontrolluesi jep informacion mbi veprimet e ndërmarra për subjektin e të dhënave pa vonesë të panevojshme.

4. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë se informacioni i dhënë sipas nenit 13 dhe çdo komunikim dhe masë e ndërmarrë sipas neneve 11,14 deri 18 dhe 31 duhet të jepet falas. Nëse kërkesat nga një subjekt të dhënash duket se janë të pabazuara ose të tepërta, veçanërisht për shkak të natyrës të tyre përsëritëse, kontrolluesi mund të:

(a) caktojë një tarifë të arsyeshme, duke marrë parasysh shpenzimet administrative të dhënies së informacionit ose komunikimit ose marrjen e masës së kërkuar; ose

(b) refuzojë të veprojë në lidhje me kërkesën.

Kontrolluesi ka barrën e demonstrimit haptazi të natyrës të pabazuar ose të tepërt të kërkesës.

5. Kur kontrolluesi ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit fizik që bën kërkesën në lidhje me nenin 14 ose 16, kontrolluesi mund të kërkojë dhënie të informacionit shtesë të nevojshëm për konfirmimin e identitetit të subjektit të të dhënave.

Neni 13

Informacion që do t'i vihet në dispozicion ose jepet subjektit të të dhënave

1. Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi të verë në dispozicion të subjektit të të dhënave të paktën informacionet e mëposhtme:

(a) identitetin dhe të dhënat e kontaktit të kontrolluesit;

(b) të dhënat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, nëse është e mundur;

(c) qëllimet e përpunimit për të cilën synohen të dhënat personale;

(d) të drejtën për të bërë një ankim te një autoritet mbikëqyrës dhe të dhënat e kontaktit të autoritetit mbikëqyrës;

(e) ekzistencën e të drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi akses, korrigjim ose fshirje të të dhënave personale dhe kufizim në përpunimin e të dhënave personale lidhur me subjektin e të dhënave.

2. Përveç informacionit të referuar në pikën 1, Shtetet Anëtare parashikojnë me ligj që në disa raste specifike kontrolluesi t'i japë subjektit të të dhënave informacionet e mëposhtme që mundësojnë ushtrimin e të drejtave të tij/saj:

(a) bazën ligjore lidhur me përpunimin;

(b) periudhën për të cilën do të ruhen të dhënat personale, ose, kur kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për përcaktimin e kësaj periudhe;

- (c) kategoritë e marrësve të të dhënave personale, sipas rastit, duke përfshirë vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare;
- (d) informacione të mëtejshme, kur është e nevojshme, veçanërisht në rastet kur të dhënat personale mblidhen pa dijeninë e subjektit të të dhënave.

3. Shtetet Anëtare mund të miratojnë masa legjislative që vonojnë, kufizojnë ose nuk parashikojnë vënien në dispozicion të informacionit për subjektin e të dhënave, në përputhje me pikën 2, deri sa dhe për aq kohë sa, kjo është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme në një shoqëri demokratike, që respekton të drejtat themelore dhe interesat legjitime të personave fizikë, me qëllim që të:

- (a) shmangin pengesat ndaj kërkesave, hetimeve apo procedurave zyrtare apo ligjore;
- (b) shmangin cenimin e parandalimit, zbulimit, hetimit apo ndjekjes penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale;
- (c) mbrojnë sigurinë publike;
- (d) mbrojnë sigurinë kombëtare;
- (e) mbrojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

4. Shtetet Anëtare mund të miratojnë masa legjislative për përcaktimin e kategorive të përpunimit, që mund të kategorizohen plotësisht apo pjesërisht nën një prej çështjeve të renditura në pikën 3.

Neni 14

E drejta e aksesit për subjektin e të dhënave

Sipas nenit 15, Shtetet Anëtare garantojnë të drejtën e subjektit të të dhënave për të marrë konfirmimin e kontrolluesit për faktin nëse po përpunohen ose jo të dhënat e tij/saj personale, dhe, nëse po, të garantohet akses në të dhënat personale dhe në informacionet e mëposhtme:

- (a) qëllimet dhe bazën ligjore për përpunimin;
- (b) kategoritë përkatëse të të dhënave personale;
- (c) marrësit apo kategoritë e marrësve me të cilët janë ndarë të dhënat personale, veçanërisht marrësit në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare;
- (d) nëse është e mundur, periudhën e parashikuar për të cilën do të ruhen të dhënat personale, ose, nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për përcaktimin e kësaj periudhe;
- (e) ekzistencën e të drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi korigjim ose fshirje të të dhënave personale ose kufizim në përpunimin e të dhënave personale të subjektit të të dhënave;
- (f) të drejtën për të bërë një ankim tek autoriteti mbikëqyrës dhe të dhënat e kontaktit të autoritetit mbikëqyrës;
- (g) informim rreth të dhënave personale që do t'i nënshtrohen përpunimit dhe çdo informacion të disponueshëm rreth origjinës së tyre.

Neni 15

Kufizimet e të drejtës së aksesit

1. Shtetet Anëtare mund të miratojnë masa legjislative që kufizojnë plotësisht ose pjesërisht të drejtën e aksesit të subjektit të të dhënave, deri sa dhe për aq kohë sa, ky kufizim, i pjesshëm apo i plotë, është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme në një shoqëri demokratike, që respekton të drejtat themelore dhe interesat legjitime të personave fizikë, me qëllim që të:

- (a) mos pengesat pengojnë kërkesat, hetimet apo procedurat zyrtare apo ligjore;
- (b) shmangin cenimin e parandalimit, zbulimit, hetimit apo ndjekjes penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale;
- (c) mbrojnë sigurinë publike;

- (d) mbrojnë sigurinë kombëtare;
 - (e) mbrojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.
2. Shtetet Anëtare mund të miratojnë masa legislative për të përcaktuar kategoritë e përpunimit, që mund të kategorizohen plotësisht ose pjesërisht në geramat (a) dhe (e) të pikës 1.
3. Në rastet e referuara në pikat 1 dhe 2, Shtetet Anëtare sigurojnë që kontrolluesi ta informojë në kohë subjektin e të dhënave, me shkrim për çdo refuzim apo kufizim të aksesit, si dhe arsyet për refuzimin apo kufizimin. Informacione të tilla mund të mos jepen kur dhënia e tyre do të cenonte një prej qëllimeve të pikës 1. Shtetet Anëtare parashikojnë që kontrolluesi ta informojë subjektin e të dhënave rreth mundësisë për depozitim të një ankimi në një autoritet mbikëqyrës ose ndjekjen e rrugës gjyqësore.
4. Shtetet Anëtare parashikojnë që kontrolluesi të dokumentojë arsyet faktike apo ligjore mbi të cilat mbështetet vendimi. Ky informacioni i vihet në dispozicion autoritetit mbikëqyrës.

Neni 16

E drejta për korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale dhe kufizimin në përpunim e tyre

1. Shtetet Anëtare garantojnë të drejtën e subjektit të të dhënave për korrigjimin në kohë nga kontrolluesi të të dhënave të pasakta personale. Duke marrë parasysh qëllimet e përpunimit, Shtetet Anëtare garantojnë të drejtën e subjektit të të dhënave për plotësimin e të dhënave të paplota personale, si dhe përmes dhënies së një deklaratë shtesë.
2. Shtetet Anëtare kërkojnë nga kontrolluesi fshirjen në kohë të të dhënave personale dhe garantimin e së drejtës së subjektit të të dhënave për të fshirjen në kohë nga kontrolluesi të të dhënave të tij/të saj personale, kur përpunimi shkel dispozitat e miratuara në përputhje me Nenin 4, 8 ose 10, ose kur të dhënat personale duhen fshirë për të përmbushur një detyrim ligjor që duhet të zbatohet nga kontrolluesi.
3. Në vend të fshirjes, kontrolluesi e kufizon përpunimin në rastet kur:
- (a) saktësia e të dhënave personale kundërshtohet nga subjekti i të dhënave dhe saktësia apo pasaktësia e tyre nuk mund të vërtetohet; ose
 - (b) të dhënat personale duhet të ruhen për qëllim prove.

Në rastet kur, në përputhje me germen (a) të nënpikës së parë, përpunimi është i kufizuar, kontrolluesi e njofton subjektin e të dhënave përpara heqjes së kufizimit të përpunimit.

4. Shtetet Anëtare sigurojnë që kontrolluesi të informojë me shkrim subjektin e të dhënave rreth çdo refuzimi të korrigjimit apo fshirjes së të dhënave personale apo kufizimit të përpunimit, dhe arsyet për refuzimin. Shtetet Anëtare mund të miratojnë masa ligjore që kufizojnë, plotësisht ose pjesërisht, detyrimin për dhënien e informacionit, deri sa dhe për aq kohë sa, ky kufizim është një masë e nevojshme në një shoqëri demokratike, që respekton të drejtat themelore dhe interesat legjitime të personave fizikë, me qëllim që të:
- (a) mos pengesat pengojnë kërkesat, hetimet apo procedurat zyrtare apo ligjore;
 - (b) shmangin cenimin e parandalimit, zbulimit, hetimit apo ndjekjes penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale;
 - (c) mbrojnë sigurinë publike;
 - (d) mbrojnë sigurinë kombëtare;
 - (e) mbrojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Shtetet Anëtare parashikojnë që kontrolluesi ta informojë subjektin e të dhënave rreth mundësisë për bërjen e një ankimi në një autoritet mbikëqyrës ose ndjekjen e rrugës gjyqësore.

5. Shtetet Anëtare sigurojnë që kontrolluesi të vërë në me dije autoritetin kompetent nga i cili kanë ardhur të dhënat e pasakta personale për korrigjimin e të dhënave të pasakta personale.

6. Në rastet kur të dhënat personale janë korrigjuar, fshirë apo është kufizuar përpunimi në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi t'i njoftojë marrësit, dhe që marrësi t'i korrigjojë, t'i fshijë ose të kufizojë përpunimin e të dhënave personale nën përgjegjësinë e tij.

Neni 17

Ushtrimi i të drejtave nga subjekti i të dhënave dhe verifikimi nga autoriteti mbikëqyrës

1. Në rastet e përcaktuara në nenin 13(3), nenin 15(3) dhe nenin 16(4), Shtetet Anëtare miratojnë masat që garantojnë ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave edhe nëpërmjet autoritetit kompetent mbikëqyrës.

2. Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi, në përputhje me pikën 1, të informojë subjektin e të dhënave rreth mundësisë për të ushtruar të drejtat e tij/saj nëpërmjet autoritetit mbikëqyrës.

3. Në rastet kur ushtrohet e drejta e përmendur në pikën 1, autoriteti mbikëqyrës, së paku, informon subjektin e të dhënave se janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme ose është bërë një rishikim nga autoriteti mbikëqyrës. Autoriteti mbikëqyrës, gjithashtu e informon subjektin e të dhënave rreth të drejtës së tij/saj për të kërkuar zgjidhje gjyqësore.

Neni 18

Të drejtat e subjektit të të dhënave gjatë hetimeve penale dhe procesit gjyqësor.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë ushtrimin e të drejtave të referuara në nenet 13, 14 dhe 16, në përputhje me të drejtën e Shteteve Anëtare, ku të dhënat personale ruhen në një vendim gjyqësor, regjistër ose dosje të çështjes, që përdoret gjatë hetimit apo procedimit penal.

KREU IV

Kontrolluesi dhe përpunuesi

Seksioni 1

Detyrimet e përgjithshme

Neni 19

Detyrimet e kontrolluesit

1. Shtetet Anëtare, duke marrë parasysh natyrën, fushën, përmbajtjen dhe qëllimin e përpunimit, si dhe rreziqet me shkallë të ndryshme probabiliteti dhe serioziteti për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, garantojnë që kontrolluesi të zbatojë masat e përshtatshme teknike dhe fizike për të siguruar dhe për të qenë i aftë të tregojë se përpunimi kryhet në përputhje me këtë Direktivë. Masat rishikohen dhe përditësohen, nëse është e nevojshme.

2. Në raport me përmasat e veprimtarive përpunuese, masat e përmendura në pikën 1 përfshijnë edhe zbatimin e politikave të duhura për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesi.

Neni 20

Mbrojtja e të dhënave sipas parimeve by design (sipas dizajnit) dhe by default (si parakusht/maksimalisht).

1. Shtetet Anëtare, duke marrë parasysh gjendjen aktuale, koston e zbatimit, natyrën, synimin, përmbajtjen dhe fushën e përpunimit, si dhe rreziqet, me shkallë të ndryshme probabiliteti dhe serioziteti, ndaj të drejtave dhe liritë të personave fizikë nga përpunimi, si në kohën e përcaktimit të mjeteve të përpunimit, ashtu edhe gjatë vetë përpunimit, garantojnë që kontrolluesi të zbatojë me efikasitet masat e duhura teknike dhe organizative, si p.sh. pseudonimizimi, të cilat janë hartuar për të zbatuar parimet e mbrojtjes së të dhënave, si p.sh. minimizimi i të dhënave, dhe të integrojë mbrojtjen e nevojshme në përpunimin e të dhënave, për të përmbushur kërkesat e kësaj Direktive dhe për të mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave.

2. Shtetet Anëtare sigurojnë që kontrolluesi të zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative, sipas parimit by default, duke garantuar përpunimin e vetëm atyre të dhënave personale që janë të nevojshme për çdo qëllim specifik të përpunimit. Ky detyrim vlen për të sasinë e të dhënave personale të mbledhura, nivelin e tyre të përpunimit, periudhën e ruajtjes dhe aksesueshmërinë e tyre. Në mënyrë të veçantë, masa të tilla garantojnë të dhënat personale, si parakusht, të mos jenë të aksesueshme nga një numër i pacaktuar personash fizikë pa ndërhyrjen e personit fizik.

Neni 21

Kontrolluesit e përbashkët

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që, në rastet e kur dy apo më shumë kontrollues përcaktojnë së bashku qëllimet dhe mjetet e përpunimit, këta të jenë kontrollues të përbashkët. Në mënyrë transparente, ata përcaktojnë përgjegjësitë përkatëse për respektimin e Direktivës, veçanërisht për sa i takon ushtrimin të të drejtave të subjektit të të dhënave dhe përgjegjësi të përkatëse për dhënien e informacionit të parashikuar në nenin 13, me anë të një marrëveshjeje midis tyre, vetëm kur dhe për aq sa kohë sa përgjegjësitë përkatëse të kontrolluesve përcaktohen nga e drejta e Bashkimit ose e Shteteve Anëtare, të cilës i nënshtrohen kontrolluesit. Marrëveshja përcakton personin e kontaktit për subjektet e të dhënave. Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë se cili prej kontrolluesve të përbashkët mund të luajë rolin e pikës së vetme të kontaktit që subjektet e të dhënave të ushtrojnë të drejtat e tyre.

2. Pavarësisht kushteve të marrëveshjes, të përcaktuara në pikën 1, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që subjekti i të dhënave të ushtrojë të drejtën e tij/saj sipas dispozitave të miratuara në përputhje me këtë Direktivë për dhe ndaj secilit kontrollues.

Neni 22

Përpunuesi

1. Në rastet kur përpunimi duhet të kryhet në emër të njërit prej kontrolluesve, Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi të përdorë vetëm ato përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative në mënyrë të tillë që përpunimi t'i përmbushë kriteret e Direktivës dhe të garantojë mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave.

2. Shtetet Anëtare parashikojnë që përpunuesi të mos angazhojë një përpunues tjetër pa miratimin përkatës paraprak ose autorizimin e përgjithshëm me shkrim nga ana e kontrolluesit. Në rast të një autorizimi të përgjithshëm me shkrim, përpunuesi informon kontrolluesin për ndryshimet e synuara lidhur me shtimin apo zëvendësimin e përpunuesve të tjerë, duke i dhënë kështu mundësi kontrolluesit që t'i kundërshtojë këto ndryshime.

3. Shtetet Anëtare garantojnë që përpunimi nga një përpunues të rregullohet me një kontratë ose një akt tjetër ligjor sipas të drejtës së Bashkimit apo Shteteve Anëtare, i cili do të ketë efekt detyrues te përpunuesi ndaj kontrolluesit, dhe që përcakton tematikën, kohëzgjatjen, natyrën dhe qëllimin e përpunimit të tij, llojin e të dhënave personale dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave, si dhe të drejtat dhe detyrimet e kontrolluesit. Në mënyrë specifike, kontrata ose akti ligjor duhet të përcaktojë që përpunuesi:

- (a) të veprojë vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit;
- (b) të garantojë që personat e autorizuar për përpunimin e të dhënave personale të jenë zotuar për konfidencialitetin ose të kenë një detyrim të posaçëm ligjor për konfidencialitetin;
- (c) ta asistojë kontrolluesin me çdo mënyrë të përshtatshme për të garantuar respektim të dispozitave për të drejtat e subjektit të të dhënave;
- (d) sipas vendimit të kontrolluesit, t'i fshijë ose t'i kthejë të gjitha të dhënat personale te kontrolluesi, pas përfundimit të ofrimit të shërbimit të përpunimit të të dhënave, dhe të fshijë çdo kopje, me përjashtim të rasteve kur e drejta e Bashkimit apo Shteteve Anëtare kërkojnë ruajtjen e të dhënave personale;

- (e) të verë në dispozicion të kontrolluesit të gjitha informacionet e nevojshme për të vërtetuar respektimin e këtij neni;
 - (f) të zbatojë kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 për angazhimin e një përpunuesi tjetër.
4. Kontrata ose akti ligjor, të përmendura në pikën 3, do të jenë me shkrim dhe në format elektronik.
5. Nëse një përpunues, në shkelje të kësaj Direktive, përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit, atëherë ky përpunues konsiderohet si një kontrollues kundrejt përpunimit në fjalë.

Neni 23

Përpunimi nën autoritetin e kontrolluesit ose përpunuesit

Shtetet Anëtare garantojnë që përpunuesi dhe çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit apo përpunuesit, i cili ka akses në të dhënat personale, të mos përpunojë të dhënat pa marrë udhëzim nga kontrolluesi, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe nga e drejta e Bashkimit apo Shteteve Anëtare.

Neni 24

Regjistrat e veprimtarisë përpunuese

1. Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi të mbajë një regjistër të të gjitha kategorive të veprimtarisë përpunuese nën përgjegjësinë e tij. Regjistri do të përmbajë informacionet e mëposhtme:
- (a) emrin dhe detajet e kontaktit të kontrolluesit, dhe sipas rastit, të kontrolluesit të përbashkët dhe të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave;
 - (b) qëllimet e përpunimit;
 - (c) kategoritë e marrësve me të cilët janë ndarë ose do të ndahen të dhënat personale, duke përfshirë marrësit në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare;
 - (d) një përshkrim të kategorive të subjektit të të dhënave dhe kategorive të të dhënave personale;
 - (e) kur është e mundur, përdorimin e profilizimit;
 - (f) nëse është e mundur, kategoritë e transferimeve të të dhënave personale ndaj vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare;
 - (g) bazën ligjore për përpunimin; përfshirë këtu transferimet, që janë dhe objektivi i synuar i të dhënave personale;
 - (h) nëse është e mundur, afatet e parashikuara kohore për fshirjen e kategorive të ndryshme të të dhënave personale;
 - (i) nëse është e mundur, një përshkrim të përgjithshëm të masave të sigurisë teknike dhe organizative të përcaktuara në nenin 29(1).
2. Shtetet Anëtare garantojnë që secili përpunues të mbajë një regjistër të të gjitha kategorive të veprimtarisë përpunuese të kryera në emër të një kontrolluesi, i cili përmban:
- (a) emrin dhe detajet e kontaktit të përpunuesit ose përpunuesve, të çdo kontrolluesi në emër të të cilit vepron përpunuesi dhe, sipas rastit, edhe nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave;
 - (b) kategoritë e përpunimit të kryer në emër të çdo kontrolluesi;
 - (c) transferimet e të dhënave personale ndaj një vendi të tretë apo një organizate ndërkombëtare, të udhëzuara qartësisht nga kontrolluesi, përfshirë këtu dhe identifikimin e atij vendi të tretë ose organizate ndërkombëtare, kur është e mundur;
 - (d) nëse është e mundur, një përshkrim të përgjithshëm të masave të sigurisë teknike dhe organizative të përcaktuara në nenin 29(1).

3. Regjistrat e përmendur në pikën 1 dhe 2 do të jenë me shkrim dhe në format elektronik.

Kontrolluesi dhe përpunuesi ia ofrojnë këto regjistra autoritetit mbikëqyrës, me kërkesë të këtij të fundit.

Neni 25

Regjistrimi

1. Shtetet Anëtare garantojnë që regjistrimi të ruhet, të paktën për operacionet e mëposhtme të përpunimit, në sistemet e automatizuara të përpunimit: mbledhja, ndryshimi, konsultimi, zbulimi (përfshirë dhe transferimet), kombinimi dhe fshirja. Regjistrat e konsultimeve dhe deklarimeve mundësojnë që këto operacione të përmbajnë të dhëna si arsyetimi, data dhe ora, dhe nëse është e mundur, identifikimin e personit që është konsultuar apo ka zbuluar të dhënat personale dhe identitetin e marrësit të të dhënave personale.
2. Regjistrat përdoren vetëm për verifikimin e ligshmërisë së përpunimit, vetëmonitorimit, garantimin e integritetit dhe sigurimin e të dhënave personale dhe për procedimet penale.
3. Kontrolluesi dhe përpunuesi ia ofrojnë këto regjistra autoritetit mbikëqyrës, me kërkesë të këtij të fundit.

Neni 26

Bashkëpunimi me autoritetin mbikëqyrës

Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi dhe përpunuesi të bashkëpunojnë sipas kërkesës me autoritetin mbikëqyrës në kryerjen e detyrave.

Neni 27

Vlerësimi i ndikimit të mbrojtja e të dhënave

1. Në rastet kur një lloj përpunimi, veçanërisht ai që përdor teknologjitë e reja, dhe duke marrë parasysh natyrën, fushën, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, ka gjasa të vërë në rrezik të drejtat dhe liritë e personave fizikë, Shtetet Anëtare sigurojnë që kontrolluesi, përpara përpunimit, të bëjë një vlerësim të ndikimit të operacioneve të parashikuara të përpunimit të mbrojtja e të dhënave personale.
2. Vlerësimi i parashikuar në pikën 1 duhet të përmbajë të paktën një përshkrim të përgjithshëm të operacioneve të parashikuara të përpunimit, një vlerësim të rrezikut të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, masat e parashikuara për adresimin e këtyre rreziqeve, mbrojtjet, masat e sigurisë dhe mekanizmat që garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale dhe vërtetojnë respektimin e kësaj Direktive, duke marrë në konsideratë të drejtat dhe interesat legjitimë të subjekteve të të dhënave dhe personave të tjerë.

Neni 28

Konsultimi paraprak me autoritetin mbikëqyrës

1. Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi ose përpunuesi të konsultohet me autoritetin mbikëqyrës para përpunimit, i cili do të bëhet pjesë e një sistemi të ri skedimi që do të ngrihet, ku:
 - (a) një vlerësim i ndikimit të mbrojtja e të dhënave, siç parashikohet në nenin 27, tregon se përpunimi do të rezultonte shumë i rrezikshëm nëse nuk do të ekzistonin masat që merren nga kontrolluesi për pakësimin e rrezikut; ose
 - (b) veçanërisht, lloji i përpunimit, për të cilin, përdorimi i teknologjive, mekanizmave ose procedurave të reja, mbart një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave.
2. Shtetet Anëtare garantojnë që autoriteti mbikëqyrës të konsultohet gjatë përgatitjes së një propozimi për një masë që do të miratohet nga parlamenti kombëtar, ose një mase rregullatore që lidhet me përpunimin.
3. Shtetet Anëtare garantojnë se autoriteti mbikëqyrës mund të krijojë një listë të operacioneve të përpunimit që i nënshtrohen konsultimeve paraprake, në përputhje me pikën 1.

4. Shtetet Anëtare garantojnë se kontrolluesi i dorëzon autoritetit mbikëqyrës vlerësimin e ndikimit të mbrojtja e të dhënave, në përputhje me nenin 27, dhe me kërkesë të tij, çdo informacion tjetër që i lejon autoritetit mbikëqyrës të bëjë një vlerësim të përputhshmërisë së përpunimit, dhe në veçanti, të rreziqeve për mbrojtjen e të dhënave personale të subjektit të të dhënave dhe mbrojtjes së tyre.

5. Kur autoriteti mbikëqyrës mendon se përpunimi i parashikuar nga pika 1 e këtij neni do të shkelte dispozitat e miratuara në përputhje me këtë Direktivë, veçanërisht kur kontrolluesi nuk ka identifikuar ose zbutur në mënyrë të mjaftueshme rrezikun, Shtetet Anëtare garantojnë që autoriteti mbikëqyrës, brenda një periudhe deri në gjashtë javë nga marrja e kërkesës për konsultim, të ofrojë këshillim me shkrim për kontrolluesin dhe, kur është e nevojshme, edhe për përpunuesin, dhe të mund të përdorë cilëndo prej kompetencave të tij të përmendura në nenin 47. Kjo periudhë mund të shtyhet deri në një muaj, duke pasur parasysh kompleksitetin e përpunimit të synuar. Për çdo shtyrje të tillë, Autoriteti mbikëqyrës informon kontrolluesin dhe, sipas rastit, përpunuesin, brenda një muaji nga marrja e kërkesës për konsultim, shoqëruar nga arsyet e vonësës.

Seksioni 2

Siguria e të dhënave personale

Neni 29

Siguria e përpunimit

1. Shtetet Anëtare, duke marrë parasysh gjendjen aktuale, koston e zbatimit, natyrën, fushën, përmbajtjen dhe qëllimin e përpunimit, si dhe rreziqe me shkallë të ndryshme probabiliteti dhe serioziteti për të drejtat dhe liritë e personave fizikë nga përpunimi, garantojnë që kontrolluesi dhe përpunuesi të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel të përshtatshëm sigurie ndaj rrezikut, veçanërisht në lidhje me përpunimin e kategorive të veçanta të dhënave personale të përmendura në nenin 10.
2. Në lidhje me përpunimin e automatizuar, çdo Shtet Anëtar garanton që çdo kontrollues ose përpunues, pas vlerësimit të rreziqeve, të zbatojë masat e hartuara për të:
 - (a) refuzuar aksesin e personave të paautorizuar në pajisjen që përdoret për përpunimin ('kontrolli i aksesit në pajisje');
 - (b) parandaluar leximin, kopjimin, ndryshimin apo fshirjen e paautorizuar të pajisjeve të ruajtjes së të dhënave ('kontrolli i pajisjeve të ruajtjes së të dhënave');
 - (c) parandaluar hedhjen e paautorizuar të të dhënave personale dhe kontrollin, ndryshimin apo fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale të ruajtura ('kontrolli i vendruajtjes');
 - (d) parandaluar përdorimin e sistemeve të automatizuara të përpunimit nga personat e paautorizuar përmes pajisjeve të komunikimit të të dhënave ('kontrolli i përdoruesit');
 - (e) garantuar që personat e autorizuar për përdorimin e një sistemi të automatizuar përpunimi, të aksesojnë vetëm ato të dhëna personale që parashikon autorizimi i aksesit të tyre ('kontrolli i aksesit të të dhënave');
 - (f) garantuar mundësinë për kryerjen e verifikimit dhe përcaktimin e organeve të cilat janë apo mund të jenë transmetuar të dhënat personale, ose të jenë ofruar përmes pajisjeve të komunikimit të të dhënave ('kontrolli i komunikimit');
 - (g) siguruar që do të jetë e mundur të verifikohet dhe të përcaktohet se cilat të dhëna personale janë hedhur në sistemet e automatizuara të përpunimit, dhe kur dhe kush i ka hedhur këto të dhëna personale ('kontrolli i hedhjes së të dhënave');
 - (h) parandaluar leximin, kopjimin, ndryshimin apo fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale gjatë transferimit të tyre ose gjatë transportimit të pajisjeve të ruajtjes së të dhënave ('kontrolli i transportit');
 - (i) garantuar rivendosjen e sistemeve të instaluar, në rast ndërprerjeje ('rikuperimi');
 - (j) garantuar kryerjen e funksioneve të sistemit, raportimin e gabimeve të shfaqura ('besueshmëria') dhe se të dhënat personale të ruajtura nuk mund të preken nga një keqfunksionim i sistemit ('integriteti').

*Neni 30***Njoftim i autoritetit mbikëqyrës për shkelje të të dhënave personale**

1. Në rast të shkeljes së të dhënave personale, Shtetet Anëtare sigurojnë që kontrolluesi të njoftojë menjëherë pa vonesa të paarsyeshme, dhe kur është e mundur, jo më vonë se 72 orë pas marrjes së informacionit, autoritetin mbikëqyrës për shkelje të të dhënave personale, me përjashtim të rasteve kur shkelja e tyre nuk ka gjasa të vërë në rrezik të drejtat dhe liritë e personave fizikë. Nëse autoriteti mbikëqyrës nuk njoftohet brenda 72 orëve, ai shoqërohet me arsyet e vonesës.
2. Përpunuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe pa vonesa të paarsyeshme kontrolluesin pasi të informohet për shkeljen e të dhënave personale.
3. Njoftimi i përmendur në pikën 1 duhet së paku:
 - (a) të përshkruajë natyrën e shkeljes së të dhënave personale, duke përfshirë, aty ku është e mundur, kategoritë dhe numrin e përafërt të subjekteve të të dhënave në fjalë dhe kategoritë dhe numrin e përafërt të të dhënave personale;
 - (b) të informojë për emrin dhe të dhënat e kontaktit të personit ose pikave të tjera të kontaktit ku mund të merret më shumë informacion;
 - (c) të përshkruajë pasojat e mundshme të shkeljes së të dhënave personale;
 - (d) të përshkruajë masat e marra ose të propozuara nga kontrolluesi për të adresuar shkeljet e të dhënave personale, si dhe, masat për zbutjen e efekteve të mundshme negative.
4. Në raste se, dhe për aq sa, nuk është e mundur të ofrojë informacion në të njëjtën kohë, informacioni mund të jepet në faza të ndryshme pa vonesa të tjera të paarsyeshme.
5. Shtetet Anëtare sigurojnë që kontrolluesi të dokumentojë çdo shkelje të të dhënave personale të përmendura në pikën 1, duke përfshirë këtu dhe faktet që kanë të bëjnë me shkeljet e të dhënave personale, efektet e saj dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra. Dokumentacioni i tillë i mundëson autoritetit mbikëqyrës të kryejë verifikimin e përmbushjes së këtij neni.
6. Në rastet kur shkelja e të dhënave personale përfshin të dhëna që janë transmetuar nga ose te kontrolluesi i një Shteti tjetër Anëtar, Shtetet Anëtare garantojnë, që informacionet e përmendura në pikën, 3 t'i komunikohen menjëherë kontrolluesit të atij Shteti Anëtar.

*Neni 31***Komunikimi i shkeljes së të dhënave personale subjektivit të të dhënave**

1. Në rastet kur shkelja e të dhënave personale ka gjasa të rezultojë në rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, Shtetet Anëtare sigurohen që kontrolluesi t'ia komunikojë menjëherë dhe pa vonesa të paarsyeshme shkeljen e të dhënave personale subjektivit të të dhënave.
2. Komunikimi me subjektin e të dhënave, parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përcakton qartë dhe thjeshtë natyrën e shkeljes së të dhënave personale dhe përmban të paktën informacionet dhe masat e përmendura në pikat (b), (c) dhe (d) të nenit 30 (3).
3. Komunikimi me subjektin e të dhënave, parashikuar në pikën 1, nuk do të jetë i nevojshëm nëse përmbushet një prej kushteve të mëposhtme:
 - (a) kontrolluesi ka zbatuar masat e duhura mbrojtëse teknologjike dhe organizative, dhe këto masa janë zbatuar për të dhënat personale subjektivit të shkeljes së të dhënave personale, veçanërisht ato që i bëjnë të dhënat të palexueshme për çdo person që nuk ka autorizim për t'i aksesuar, si p.sh. kodimi;
 - (b) kontrolluesi ka marrë masa pasuese që garantojnë që rreziku i lartë ndaj lirive dhe të drejtave të subjektivit të të dhënave, përmendur në pikën 1, nuk ka të ngjarë të ndodhë më;
 - (c) do të kërkonte një përpjekje të tepruar. Në këtë rast, subjektet e të dhënave të informohen me anë të një komunikim publik apo një masë të ngjashme në të njëjtën mënyrë efikase.
4. Nëse kontrolluesi nuk e ka informuar tashmë subjektin e të dhënave rreth shkeljes së të dhënave personale, autoriteti mbikëqyrës pasi ka marrë parasysh probabilitetin e shkeljes së të dhënave personale, që mund të rezultojë në rrezik të lartë, mund t'i kërkojë atij të parit të veprojë ose mund të vendosë nëse përmbushet një prej kushteve të përmendura në pikën 3.

5. Komunikimi me subjektin e të dhënave i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të vonohet, kufizohet ose të mos kryhet sipas kushteve dhe bazave të përmendura në nenin 13 (3).

Seksioni 3

Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave

Neni 32

Emërimi i nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave

1. Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi të emërojë një nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave. Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë nga ky detyrim gjykatat dhe autoritetet e tjera të pavarura gjyqësore kur veprojnë në cilësinë e tyre juridike.
2. Nëpunësit i mbrojtjes së të dhënave caktohet bazuar në cilësitë e tij/saj profesionale, dhe, në veçanti, njohuritë e tij/saj në nivel eksperti për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe në praktikën dhe aftësinë për të përmbushur detyrat e përcaktuara në nenin 34.
3. Një nëpunësit i vetëm për mbrojtjen e të dhënave mund të caktohet për disa autoritete kompetente, duke marrë në konsideratë strukturën organizative dhe madhësinë e tyre.
4. Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi të publikojë të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave dhe t'ia përcjellë ato autoritetit mbikëqyrës.

Neni 33

Pozicioni i nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave

1. Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi të sigurohet për angazhimin e duhur dhe në kohë të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave për të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi mbështet nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave në realizimin e detyrave të përmendura në nenin 34, duke i vënë atij/asaj në dispozicion burimet e nevojshme për kryerjen e detyrave, aksesin në të dhënat personale dhe operacionet e përpunimit, si dhe në ruajtjen e njohurive të tij/saj të specializuara.

Neni 34

Detyrat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave

Shtetet Anëtare garantojnë që kontrolluesi t'i caktojë nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave të paktën detyrat e mëposhtme:

- (a) informimin dhe këshillimin e kontrolluesit dhe punonjësit që kryejnë përpunimin sipas detyrimeve të tyre që rrjedhin nga kjo Direktivë dhe dispozitat e tjera të mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit apo Shtetit Anëtar;
- (b) monitorimin e përputhshmërisë me këtë Direktivë dhe dispozitat e tjera të mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit apo Shtetit Anëtar dhe me politikat e kontrolluesit lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë caktimin e përgjegjësive, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e stafit të angazhuar në operacionet e përpunimit, dhe auditimet përkatëse;
- (c) dhënien e këshillave, kur kërkohet, rreth vlerësimit të ndikimit të mbrojtja e të dhënave, dhe monitorimin e performancës në përputhje me nenin 27;
- (d) bashkëpunimin me autoritetin mbikëqyrës;
- (e) rolin si pikë kontakti për autoritetin mbikëqyrës në çështje që lidhen me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak të përmendur në nenin 28, dhe sipas nevojës, konsultimin për çdo çështje.

KREU V

Transferimet e të dhënave personale në vendet të treta ose organizatat ndërkombëtare

*Neni 35***Parimet e përgjithshme për transferimet e të dhënave personale**

1. Shtetet Anëtare garantojnë që çdo transferim nga autoritetet kompetente i të dhënave personale që kanë qenë subjekt i përpunimit ose synohen të përpunohen pas transferimit në një vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare, duke përfshirë transferimet e përcjella në një vend tjetër të tretë apo organizatë tjetër ndërkombëtare, është në përputhje me dispozitat kombëtare të miratuara në mbështetje të dispozitave të tjera të kësaj Direktive, vetëm kur përmbushen kushtet e parashtruara në këtë Kre, konkretisht:
 - (a) transferimi është i nevojshëm për qëllimet e parashtruara në nenin 1 (1);
 - (b) të dhënat personale transferohen te një kontrollues në një vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare që është autoriteti kompetent për qëllimet e përmendura në nenin 1(1);
 - (c) kur të dhënat personale transmetohen ose vihen në dispozicion nga një Shtet tjetër Anëtar, ky Shtet ka dhënë autorizimin e tij paraprak për transferimin në përputhje me legjislacionin vendas;
 - (d) Komisioni ka miratuar një vendim përshtatshmërie në përputhje me nenin 36, ose në mungesë të një vendimi të tillë, janë garantuar ose ekzistojnë masat e duhura mbrojtëse në përputhje me nenin 37, ose në mungesë të një vendimi përshtatshmërie sipas nenit 36 dhe të masave të duhura mbrojtëse sipas nenit 37, zbatohen derogimet për situata specifike sipas nenit 38; dhe
 - (e) në rastin e një transferimi të përcjellë në një vend tjetër të tretë apo organizatë tjetër ndërkombëtare, autoriteti kompetent që kreu transferimin fillestar apo një autoritet tjetër kompetent i po atij Shteti Anëtar autorizon përcjelljen e transferimit, pas marrjes në konsideratë të të gjithë faktorëve, ku përfshihet edhe rëndësia e veprës penale, qëllimi për transferimin fillestar të të dhënave personale dhe niveli i mbrojtjes së të dhënave personale në vendet e treta apo organizatat ndërkombëtare te të cilat përcillen të dhënat personale të transferuara.
2. Shtetet Anëtare garantojnë që transferimet pa autorizim paraprak të një Shteti tjetër Anëtar, në përputhje me parashikimet e germës (c) të pikës 1, të lejohen vetëm nëse transferimi i të dhënave personale është i nevojshëm për parandalimin e një kërcënimi të çastit dhe serioz ndaj sigurisë publike të një Shteti Anëtar, vendi të tretë, ose ndaj interesave thelbësore të një Shteti Anëtar, dhe kur autorizimi paraprak nuk mund të merret në kohën e duhur. Autoriteti përgjegjës për dhënien e autorizimit paraprak informohet menjëherë.
3. Të gjitha dispozitat e këtij Kreu do të zbatohen për të garantuar mosçenimin e nivelit të mbrojtjes së personave fizikë nga kjo Direktivë.

*Neni 36***Transferimet në përputhje me në një vendim përshtatshmërie**

1. Shtetet Anëtare garantojnë që transferimi i të dhënave personale në një vend të tretë apo organizatë ndërkombëtare mund të kryhet kur Komisioni ka vendosur që vendi i tretë, një pjesë territori apo i një ose më shumë sektorë të posaçëm brenda atij vendi të tretë, ose organizata ndërkombëtare në fjalë garanton një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje. Transferimi i tillë nuk kërkon autorizim të veçantë.
2. Kur vlerësohet përshtatshmërinë e nivelit të mbrojtjes, Komisioni merr në konsideratë elementët e mëposhtëm:
 - (a) shtetin e së drejtës, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, legjislacionin përkatës, si të përgjithshmin ashtu edhe atë të posaçëm, sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë kombëtare dhe të drejtën penale, aksesin e autoriteteve publike në të dhënat personale, si dhe zbatimin e këtij legjislacioni, rregullat për mbrojtjen e të dhënave, rregullat profesionale dhe masat e sigurisë, duke përfshirë rregullat për përcjelljen e transferimit të të dhënave personale në një vend të tretë apo organizatë ndërkombëtare, praktikën gjyqësore, dhe të drejtat efikase dhe të zbatueshme të subjektit të të dhënave dhe dëmshpërblimit ligjor për subjektet e të dhënave, të dhënat personale të të cilëve janë transferuar;
 - (b) ekzistencën dhe funksionimin efikas të një ose më shumë autoriteteve mbikëqyrëse të pavarura në një vend të tretë ose ndaj së cilës nënshtrohet një organizatë ndërkombëtare, me përgjegjësinë e garantimit dhe zbatimit të rregullave të mbrojtjes së të dhënave, duke përfshirë kompetenca të përshtatshme ekzekutimi, për të asistuar dhe këshilluar subjektet e të dhënave në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe për të bashkëpunuar me autoritetin mbikëqyrës të Shteteve Anëtare; dhe

(c) angazhimet ndërkombëtare që ka marrë përsipër vendi i tretë ose organizata ndërkombëtare, ose detyrime të tjera që rrjedhin nga konventat apo instrumentet ligjërishit detyruese, si dhe nga pjesëmarrja e tij në sisteme shumëpalëshe apo rajonale, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Pas vlerësimit të përshtatshmërisë së nivelit të mbrojtjes, Komisioni, nëpërmjet aktit zbatues, mund të vendosë që një vend i tretë, një territor ose një ose më shumë sektorë të posaçëm brenda një vendi të tretë ose një organizate ndërkombëtare garanton një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje në kuadër të pikës 2 të këtij Neni. Akti zbatues parashikon një mekanizëm për rishikimin periodik, të paktën një herë në katër vjet, që merr parasysh të gjitha zhvillimet përkatëse në vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare. Akti zbatues specifikon zbatimin e tij territorial dhe sektorial dhe, sipas rastit, identifikon autoritetin ose autoritetet mbikëqyrëse të përmendura në germën (b) të pikës 2 të këtij neni. Akti zbatues miratohet në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 58(2);

4. Në vazhdimësi, Komisioni monitoron zhvillimet në vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare që mund të ndikojnë në funksionimin e vendimeve të miratuara në përputhje me pikën 3.

5. Nëse vihet në dukje nga informacioni i ofruar, veçanërisht pas rishikimit të përmendur në pikën 3 të këtij Neni, se një vend i tretë, një territor ose një ose disa sektorë të posaçëm të një vendi të tretë ose një organizate ndërkombëtare nuk vazhdon të garantojë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje në kuptimin e pikës 2 të këtij neni, sipas nevojës, Komisioni anulon, ndryshon ose pezullon vendimin e përmendur në pikën 3 të këtij neni, nëpërmjet akteve zbatuese pa efekt prapaveprues. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 58(2).

Në rastet e urgjencave të menjëhershme të justifikuar, Komisioni miraton menjëherë aktet zbatuese në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 58 (3).

6. Komisioni konsultohet me vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare, me synim zgjidhjen e situatës që ka sjellë si pasojë vendimin e marrë në përputhje me pikën 5.

7. Shtetet Anëtare japin një vendim në përputhje me pikën 5 pa paragjykime për transferimet e të dhënave personale ndaj vendit të tretë, territorit ose një ose më shumë sektorëve të posaçëm brenda vendit të tretë, ose organizatës ndërkombëtare në fjalë në përputhje me nenin 37 dhe 38.

8. Komisioni publikon në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian* dhe në faqen e internetit një listë të vendeve të treta, territoreve dhe sektorëve të posaçëm brenda një vendi të tretë dhe organizatave ndërkombëtare për të cilat ai ka vendosur që nëse ofrohet apo jo një nivel i përshtatshëm mbrojtjeje.

Neni 37

Transferimet i nënshtrohen mbrojtjes së përshtatshme

1. Në mungesë të një vendimi në përputhje me nenin 36(3), Shtetet Anëtare garantojnë që transferimi i të dhënave personale te një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare të kryhet me kusht që:

(a) të ofrohet mbrojtje e përshtatshme lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale sipas një instrumenti ligjërishit detyrues; ose

(b) kontrolluesi të vlerësojë të gjitha rrethanat e transferimit të të dhënave personale dhe arrin në përfundimin se ka mbrojtje të përshtatshme lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Kontrolluesi informon autoritetin mbikëqyrës rreth kategorive të transferimit sipas germës (b) të pikës 1.

3. Në rastet kur transferimi mbështetet në germën (b) të pikës 1, ai dokumentohet dhe ky dokumentacion i vihet në dispozicion me kërkesë autoritetit mbikëqyrës, duke përfshirë datën dhe orën e transferimit, informacion rreth autoritetit kompetent marrës, arsyes së transferimit dhe të dhënave personale të transferuara.

*Neni 38***Derogimet (Përjashtimet) për situata specifike**

1. Në mungesë të një vendimi përshtatshmërie në pajtim me nenin 36, ose të mbrojtjes së përshtatshme sipas nenit 37, Shtetet Anëtare garantojnë që transferimi ose një grup transferimesh të të dhënave personale te një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare të kryhet vetëm kur transferimi është i nevojshëm:
 - (a) për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose të personave të tjerë;
 - (b) për mbrojtjen e interesave legjitime të subjektit të të dhënave, atëherë kur parashikohet nga e drejta e Shteteve Anëtare për transferimin e të dhënave personale;
 - (c) për parandalimin e një kërcënimi direkt dhe serioz ndaj sigurisë publike të një Shteti Anëtar ose vendi të tretë;
 - (d) për raste të veçanta, për qëllimet e parashtruara në nenin 1 (1); ose
 - (e) për një rast të veçantë, për krijimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore lidhur me qëllimet e parashtruara në nenin 1 (1).
2. Të dhënat personale nuk transferohen nëse autoriteti kompetent transferues përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave tejkalojnë interesin publik në transferimin e parashtruar në germën (d) dhe (e) të pikës 1.
3. Në rastet kur transferimi mbështetet në pikën 1, ai dokumentohet dhe ky dokumentacion i vihet në dispozicion me kërkesë autoritetit mbikëqyrës, duke përfshirë datën dhe orën e transferimit, informacion rreth autoritetit kompetent marrës, arsyes së transferimit dhe të dhënave personale të transferuara.

*Neni 39***Transferimi i të dhënave personale te marrësit e vendeve të treta**

1. Përmes derogimit nga germa (b) e nenit 35(1) dhe pa cenuar ndonjë marrëveshje ndërkombëtare të përmendur në pikën 2 të këtij neni, Bashkimi ose Shtetet Anëtare mund të sigurojnë që autoritetet kompetente të përmendura në pikën (7) (a) të nenit 3, në raste specifike ose të veçanta, të transferojnë drejtpërdrejtë të dhënat personale te marrësit e përcaktuar në vendet e treta, vetëm nëse respektohen dispozitat e tjera të kësaj Direktive dhe përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - (a) transferimi është i nevojshëm për kryerjen e një detyre të autoritetit kompetent transferues, siç parashikohet nga e drejta e Bashkimit ose Shtetit Anëtar për qëllimet e parashtruara në nenin 1 (1);
 - (b) autoriteti kompetent transferues përcakton që asnjë e drejtë dhe liri themelore e subjektit të të dhënave të mos vihet mbi interesin publik në rast nevoje të transferimit për çështjen në fjalë;
 - (c) autoriteti kompetent transferues gjykon se transferimi te një autoritet tjetër kompetent për qëllimet e përmendura në nenin 1(1) në vendet e treta nuk është efikas apo i përshtatshëm, veçanërisht sepse transferimi nuk mund të bëhet në afate të pranueshme;
 - (d) autoriteti kompetent për qëllimet e referuara në nenin 1(1) në vendet e treta informohet në kohë, me përjashtim të rasteve kur ky informacion nuk është i dobishëm apo i duhuri;
 - (e) autoriteti kompetent transferues informon marrësin për qëllimin apo qëllimet e specifikuar për të cilat të dhënat personale do të përpunohen vetëm nga ky i fundit, me kusht që përpunimi është i nevojshëm.
2. Marrëveshja ndërkombëtare e përmendur në pikën 1 është një marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe në fuqi ndërmjet Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështje penale dhe bashkëpunimin policor.
3. Autoriteti kompetent transferues informon autoritetin mbikëqyrës rreth transferimeve sipas këtij neni.
4. Në rast se një transferim kryhet në përputhje me pikën 1, ai duhet të dokumentohet.

*Neni 40***Bashkëpunimi ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale**

Në lidhje me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, Komisioni dhe Shtetet Anëtare marrin masat e duhura për të:

- (a) ngritur mekanizmat e bashkëpunimit ndërkombëtar që të lehtësohet zbatimi efikas i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- (b) ofruar ndihmë reciproke ndërkombëtare në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë njoftimin, referimin e ankimeve, ndihmën në hetim dhe shkëmbimin e informacionit, që i nënshtrohen masave të ruajtjes për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave dhe lirive të tjera themelore;
- (c) angazhuar palët përkatëse të interesit në diskutime dhe aktivitete që synojnë marrëdhëniet e mëtejshme ndërkombëtare në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- (d) nxitur shkëmbimin dhe dokumentimin e legjislacionit dhe praktikës për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë konfliktet juridiksionale me vendet e treta.

*KREU VI***Autoritetet e pavarura mbikëqyrëse**

Seksioni 1

Statusi i pavarur*Neni 41***Autoriteti mbikëqyrës**

1. Çdo Shtet Anëtar cakton një ose më shumë autoritete mbikëqyrëse të pavarura si përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj Direktive, me qëllim që të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë lidhur me përpunimin dhe lehtësimin e qarkullimit të lirë të të dhënave personale brenda Bashkimit ('autoriteti mbikëqyrës').
2. Secili autoritet mbikëqyrës kontribuon në zbatimin konsistent të kësaj Direktive në të gjithë Bashkimin. Për këtë qëllim, autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me Komisionin në përputhje me Kreun VII.
3. Shtetet Anëtare mund të caktojnë që një autoritet mbikëqyrës i krijuar në përputhje me Rregulloren (BE) 2016/79 të jetë autoriteti mbikëqyrës përcaktuar në këtë Direktivë dhe të marrë përsipër përgjegjësinë për detyrat e autoritetit mbikëqyrës, që ngrihet sipas pikës 1 të këtij neni.
4. Në rast të ngritjes të më shumë se një autoriteti mbikëqyrës në një Shtet Anëtar, vetë shteti përcakton autoritetin mbikëqyrës që duhet të përfaqësojë këto autoritete në Bordin e përmendur në nenin 51.

*Neni 42***Pavarësia**

1. Secili Shtet Anëtar garanton që çdo autoritet mbikëqyrës të veprojë me pavarësi të plotë në kryerjen e detyrave të tij dhe në ushtrimin e kompetencave në përputhje me këtë Direktivë.
2. Shtetet Anëtare sigurojnë që anëtari ose anëtarët e autoriteteve të tyre mbikëqyrës në kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të tyre në pajtim me këtë Direktivë, të mos preken nga ndikimet e jashtme, qofshin të drejtpërdrejta ose jo, dhe të mos kërkojnë apo të marrin udhëzime nga të tjerë.
3. Anëtarët e autoriteteve mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare kufizohen nga çdo veprim që bie ndesh me detyrat e tyre dhe, gjatë mandatit të tyre, nuk angazhohen me punë të papajtueshme, qofshin fitimprurëse ose jo.
4. Secili Shtet Anëtar garanton që çdo autoritet mbikëqyrës të ketë burimet njerëzore, teknike dhe financiare, godinat dhe infrastrukturën e nevojshme për kryerjen me efikasitet të detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të tij, duke përfshirë dhe ato që duhen kryer në kontekstin e asistencës reciproke, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në Bord.

5. Secili Shtet Anëtar garanton që çdo autoritet mbikëqyrës të zgjedhë dhe të ketë stafin e tij, i cili do të jetë nën drejtimin vetëm të anëtarit apo anëtarëve të autoritetit mbikëqyrës përkatës.

6. Secili Shtet Anëtar garanton që çdo autoritet mbikëqyrës t'i nënshtrohet kontrollit financiar, i cili nuk ndikon në pavarësinë e tij, dhe që të ketë buxhete vjetore publike të veçanta, të cilat mund të jenë pjesë e një buxheti të përgjithshëm të shtetit.

Neni 43

Kushtet e përgjithshme për anëtarët e autoritetit mbikëqyrës

1. Shtetet Anëtare garantojnë që çdo anëtar i autoriteteve të tyre mbikëqyrëse të emërohet përmes një procedure transparente nga:

- parlamenti i tyre;
- qeveria e tyre;
- krerët e shteteve; ose
- një organ i pavarur, të cilit i është besuar emërimi sipas së drejtës së Shteteve Anëtare.

2. Çdo anëtar ka kualifikimet, përvojën dhe aftësitë e tij, veçanërisht në sferën e mbrojtjes së të drejtave personale, që kërkohen për të përmbushur detyrat dhe për të ushtruar kompetencat e tij.

3. Detyrat e një anëtari përfundojnë në rastin e përfundimit të mandatit, dorëheqje ose daljes së detyruar në pension, në përputhje me të drejtën e Shtetit Anëtar përkatës.

4. Një anëtar lirohet nga detyra, vetëm në rastet e sjelljes së papranueshme ose nëse anëtari nuk i përmbush më kushtet e kërkuara për kryerjen e detyrave.

Neni 44

Rregullat për ngritjen e autoritetit mbikëqyrës

1. Çdo Shtet Anëtar parashikon me ligj të mëposhtmet:

- (a) ngritjen e çdo autoriteti mbikëqyrës;
- (b) kualifikimet dhe kushtet e pranimit për t'u emëruar anëtar i çdo autoriteti mbikëqyrës;
- (c) rregullat dhe procedurat për emërimin e anëtarit apo anëtarëve të çdo autoriteti mbikëqyrës;
- (d) kohëzgjatjen e mandatit të anëtarit apo anëtarëve të çdo autoriteti mbikëqyrës jo më shumë se katër vjet, me përjashtim të emërimit të parë pas datës 6 maj 2016, që mund të jetë për një periudhë më të shkurtër, me qëllim mbrojtjen e pavarësisë së autoritetit mbikëqyrës nëpërmjet një procedure me faza emërimi;
- (e) nëse dhe për sa mandate anëtari apo anëtarët e çdo autoriteti mbikëqyrës janë të pranueshëm për t'u riemëruar;
- (f) kushtet që udhëheqin detyrimet e anëtarit apo anëtarëve dhe stafit të çdo autoriteti mbikëqyrës, ndalimet për veprime, punë dhe përfitime të papërputhshme me mandatin, gjatë tij dhe pas tij, dhe rregullat që rregullojnë ndërprerjen e kontratës së punës.

2. Anëtari apo anëtarët dhe stafi i çdo autoriteti mbikëqyrës, në përputhje me të drejtën e Bashkimit apo Shtetit Anëtar, i nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional gjatë dhe pas kohës së punësimit, në lidhje me çdo informacion konfidencial për të cilin kanë marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrave apo ushtrimit të kompetencave të tyre. Gjatë mandatit të tyre, detyrimi e sekretit profesional vlen në mënyrë të veçantë për raportimin e shkeljeve të kësaj Direktive nga personat fizikë.

Seksioni 2

Kompetencat, detyrat dhe autoritetet*Neni 45***Kompetencat**

1. Çdo Shtet Anëtar garanton që çdo autoritet mbikëqyrës të jetë kompetent për kryerjen e detyrave të caktuara dhe ushtrimin e kompetencave të dhëna në pajtim me këtë Direktivë në territorin e Shtetit të vetë Anëtar.
2. Çdo Shtet Anëtar garanton që çdo autoritet mbikëqyrës të mos ketë kompetencë për mbikëqyrjen e operacioneve përpunuese të gjykatave që veprojnë në cilësinë e tyre juridike. Shtetet Anëtare mund të garantojnë që autoriteti i tyre mbikëqyrës të mos ketë kompetencë për mbikëqyrjen e operacioneve përpunuese të autoriteteve të tjera të pavarura gjyqësore që veprojnë në cilësinë e tyre juridike.

*Neni 46***Detyrat**

1. Çdo Shtet Anëtar garanton që çdo autoritet mbikëqyrës në territorin e tij:
 - (a) monitoron dhe realizon zbatimin e dispozitave të miratuara në përputhje me këtë Direktivë dhe masave të saj zbatuese;
 - (b) nxit ndërgjegjësimin dhe kuptueshmërinë e publikut ndaj rreziqeve, rregullave, garancive dhe të drejtave në lidhje me përpunimin;
 - (c) këshillon, në përputhje me të drejtën e Shtetit Anëtar, parlamentin, qeverinë, institucionet dhe organet e tjera për masat legjislative dhe administrative në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë për sa i takon përpunimit;
 - (d) nxit ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe përpunuesve për detyrimet e tyre sipas kësaj Direktive;
 - (e) i jep informacion çdo subjekti të të dhënave në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tyre sipas kësaj Direktive me kërkesë, dhe sipas rastit, bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse në Shtetet e tjera Anëtare për këtë qëllim;
 - (f) trajton ankimet e paraqitura nga një subjekt i të dhënave ose nga një organ, organizatë ose shoqatë në përputhje me nenin 55 dhe heton, deri në shkallën e lejuar, subjektin e ankimit dhe informon ankimuesin në lidhje me ecurinë dhe rezultatin e hetimit brenda një afati të arsyeshëm, veçanërisht nëse është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm apo bashkërendimi me një organ tjetër mbikëqyrës;
 - (g) kontrollon ligjshmërinë e përpunimit në përputhje me nenin 17 dhe informon subjektin e të dhënave brenda afateve të lejuara për rezultatin e kontrollit të kryer në përputhje me pikën 3 të këtij neni ose arsyet pse nuk është kryer kontrolli;
 - (h) bashkëpunon, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit, dhe ofron ndihmën e ndërsjellë me autoritetet e tjera mbikëqyrëse me qëllim garantimin e vijueshmërisë së zbatimit dhe ekzekutimit të kësaj Direktive;
 - (i) kryen hetime në lidhje me zbatimin e kësaj Direktive, edhe në bazë të informacionit të marrë nga një autoritet tjetër mbikëqyrës ose autoritet tjetër publik;
 - (j) monitoron zhvillimet përkatëse, në masën që ato kanë ndikim mbi mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht zhvillimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit;
 - (k) jep këshillim për operacionet e përpunimit të përmendura në nenin 28; dhe
 - (l) kontribuon në aktivitetet e Bordit.
2. Çdo autoritet mbikëqyrës lehtëson bërjen e ankimeve të përmendura në germën (f) të pikës 1 me anë të masave të tilla si një formular për depozitimin e kërkesës, i cili mund të plotësohet edhe në mënyrë elektronike, pa përjashtuar rrugë të tjera komunikimi.

3. Kryerja e detyrave të tjera nga secili autoritet mbikëqyrës është falas për subjektin e të dhënave dhe për nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave.

4. Nëse kërkesat janë haptazi të pabazuara ose të tepruara, veçanërisht për shkak të natyrës së tyre përsëritës, autoriteti mbikëqyrës mund të vendosë një tarifë të arsyeshme, bazuar në shpenzimet administrative ose të refuzojë të veprojë ndaj kërkesës. Autoriteti mbikëqyrës ka për detyrë të vërtetojë që kërkesa është e pabazuar ose e tepruar.

Neni 47

Autoritetet

1. Secili Shtet Anëtar parashikon me ligj që çdo autoritet mbikëqyrës të ketë autoritet të efektshme për hetim. Këto autoritete përfshijnë të paktën të drejtën për të marrë nga kontrolluesi dhe përpunuesi aksesin në të gjitha të dhënat personale që po përpunohen dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave.

2. Secili Shtet Anëtar parashikon me ligj që çdo autoritet mbikëqyrës të ketë autoritet të efektshëm korrigjues, si:

- (a) të japë paralajmërime për një kontrollues ose përpunues që operacionet e synuara përpunuese mund të shkelin dispozitat e kësaj Direktive;
- (b) të urdhërojë kontrolluesin ose përpunuesin t'i bëjë operacionet e përpunimit në përputhje me dispozitat e miratuara në përputhje me këtë Direktivë, sipas rastit, në një mënyrë të caktuar dhe brenda një afati të specifikuar, veçanërisht duke urdhëruar korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit në përputhje me nenin 16;
- (c) të vendosë një kufizim të përkohshëm ose të përhershëm, duke përfshirë dhe ndalimin e përpunimit;

3. Çdo Shtet Anëtar parashikon me ligj që secili autoritet mbikëqyrës ka kompetencat efikase këshilluese për të këshilluar kontrolluesin në përputhje me procedurën paraprake të konsultimeve të përmendur në nenin 28; dhe të japë, me nismën e tij ose me kërkesë, mendime për parlamentin, qeverinë e tij, ose në përputhje me ligjet vendase, për institucionet dhe organet e tjera, si dhe për publikun për çdo çështje në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;

4. Ushtrimi i autoritetit që i është dhënë autoritetit mbikëqyrës në përputhje me këtë nen i nënshtrohet mbrojtjes së përshtatshme, duke përfshirë rrugët efikase gjyqësore dhe procesin e rregullt, siç parashtrrohet në të drejtën e Bashkimit dhe Shtetit Anëtar në përputhje me Kartën.

5. Secili Shtet Anëtar parashikon me ligj që autoriteti i tij mbikëqyrës të ketë autoritet që shkeljet e kësaj Direktive t'i sjellë në vëmendje të autoriteteve gjyqësore dhe sipas rastit, të fillojë ose të angazhohet ndryshe në çështje gjyqësore, me qëllim që të zbatojë dispozitat e miratuara në përputhje me këtë Direktivë.

Neni 48

Raportimi i shkeljeve

Shtetet Anëtare garantojnë që autoritetet kompetente ngrenë mekanizmat efikas për të nxitur raportimin konfidencial të shkeljeve të kësaj Direktive.

Neni 49

Raportet për veprimtarinë

Çdo autoritet mbikëqyrës përpilon një raport vjetor për veprimtarinë e tij, që mund të përfshijë një listë të llojeve të shkeljeve të njoftuara dhe të penaliteteve të vëna. Këto raporte u përcillen parlamenteve, qeverive dhe autoriteteve të tjera që përcaktohen nga e drejta e Shtetit Anëtar. Ato vihen në dispozicion të publikut, Komisionit dhe Bordit.

*KREU VII***Bashkëpunimi***Neni 50***Ndihma e ndërsjellë**

1. Çdo Shtet Anëtar garanton që autoritetet e tyre mbikëqyrës t'i japë njëri-tjetrit informacionin e duhur dhe ndihmën e ndërsjellë për të zbatuar këtë Direktivë në mënyrë konsistente dhe merr masat për bashkëpunim të efektshëm me njëri-tjetrin. Ndihma e ndërsjellë, veçanërisht, mbulon kërkesat për informacion dhe masat mbikëqyrëse, si kërkesat për konsultimet, inspektimet dhe hetimet.
2. Çdo Shtet Anëtar garanton që secili autoritet mbikëqyrës të marrë të gjitha masat e nevojshme të kërkuara për t'iu përgjigjur një kërkesë të një autoriteti tjetër menjëherë dhe jo më vonë se një muaj pas marrjes së kërkesës. Në mënyrë të veçantë, kjo kërkesë mund të përfshijë transmetimin e informacionit për kryerjen e një hetimi.
3. Kërkesat për ndihmë përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, duke përfshirë qëllimin dhe arsyet e kërkesës. Informacioni i shkëmbyer përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është kërkuar.
4. Autoriteti mbikëqyrës i kërkuar nuk refuzon përmbushjen e kërkesës, me përjashtim të rasteve kur:
 - (a) nuk është kompetent për përmbajtjen e kërkesës ose për masat që kërkohen të ekzekutohen përmes saj; ose
 - (b) përmbushja e kërkesës do të shkelte këtë Direktivë ose të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet autoriteti mbikëqyrës që merr kërkesën.
5. Autoriteti mbikëqyrës i kërkuar njofton autoritetin mbikëqyrës kërkues për rezultatet ose, sipas rastit, për ecurinë e masave të marra për t'iu përgjigjur kërkesës. Autoriteti mbikëqyrës i kërkuar jep arsyet për çdo refuzim për t'iu përgjigjur një kërkesë në përputhje me pikën 4.
6. Si rregull, autoritetet mbikëqyrëse të kërkuara e japin informacionin e kërkuar nga autoritetet e tjera në mënyrë elektronike, duke përdorur një format të standardizuar.
7. Autoritetet mbikëqyrëse të kërkuara nuk vendosin tarifa për asnjë veprim të ndërmarrë prej tyre sipas një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë. Autoritetet mbikëqyrëse mund të bien dakord për rregullat për të zhdëmtuar njëri-tjetrin për shpenzimet specifike që rrjedhin nga dhënia e ndihmës së ndërsjellë në rrethana të veçanta.
8. Komisioni, përmes akteve zbatuese, mund të specifikojë formatin dhe procedurat për ndihmë të ndërsjellë të përmendur në këtë nen dhe masat për shkëmbimin e informacionit në mënyrë elektronike ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, dhe ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe Bordit. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 58(2).

*Neni 51***Detyrat e Bordit**

1. Bordi i krijuar me Rregulloren (BE) 2016/679 kryen të gjitha detyrat e mëposhtme në lidhje me përpunimin brenda fushëveprimit të Direktivës:
 - (a) këshillon Komisionin për çdo çështje në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në Bashkim, si dhe për çdo ndryshim të propozuar të kësaj Direktive;
 - (b) shqyrton, me nismën e tij, me kërkesë të një prej anëtarëve të tij ose me kërkesë të Komisionit, çdo çështje që mbulon zbatimin e kësaj Direktive dhe nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat më të mira me qëllim që të nxisë ekzekutimin e njëtrajtshëm të kësaj Direktive;
 - (c) harton udhëzime për autoritetet mbikëqyrëse për zbatimin e masave të përmendura në nenin 47 (1) dhe (3);
 - (d) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat me të mira në përputhje me germën (e) të kësaj nënpike për konstatimin e shkeljeve të të dhënave personale dhe përcaktimin e vonësës së paarsyeshme të përmendur në Nenin 30(1) dhe (2) dhe për rrethanat e veçanta në të cilat një kontrolluesi ose përpunuesi i kërkohet të njoftojë shkeljen e të dhënave personale;

- (e) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat me të mira në përputhje me germën (b) të kësaj nënpike për rrethanat në të cilat një shkelje e të dhënave personale mund të rezultojë në një rrezik të madh për të drejtat dhe liritë e personave fizikë të përmendur në nenin 31 (1);
- (f) rishikon zbatimin praktik të udhëzimeve, rekomandimeve dhe praktikave më të mira përmendura në germat (b) dhe (c);
- (g) i jep Komisionit mendim për vlerësimin e përshtatshmërisë së nivelit të mbrojtjes në një vend të tretë, një territor ose një ose më shumë sektorë të posaçëm brenda atij vendi të tretë, ose organizate ndërkombëtare, duke përfshirë vlerësimin nëse ky vend i tretë, territor, sektor i posaçëm ose organizatë ndërkombëtare vazhdon të ofrojë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje;
- (h) nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e efektshëm dypalësh dhe shumëpalësh të informacionit dhe praktikat më të mira ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse;
- (i) nxit programet e përbashkëta të trajnimit dhe lehtëson shkëmbimet e personelit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe sipas rastit, me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare;
- (j) nxit shkëmbimin e njohurive dhe dokumentacionit për legjislacionin dhe praktikën e mbrojtjes së të dhënave me autoritetet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave në të gjithë botën;

Në lidhje me germën (g) të nënpikës së parë, Komisioni i ofron Bordit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke përfshirë korrespondencën me qeverinë e vendit të tretë, territorin ose sektorin e posaçëm brenda atij vendi të tretë, ose brenda organizatës ndërkombëtare.

2. Nëse Komisioni kërkon këshillim nga Bordi, ai mund të tregojë një afat, duke marrë parasysh urgjencën e çështjes.
3. Bordi ia paraqet mendimet, udhëzimet, rekomandimet dhe praktikat më të mira Komisionit dhe komitetit, të cilat përmenden në nenin 58(1) dhe i bën ato publike.
4. Komisioni informon Bordin rreth veprimeve që ka ndërmarrë në vijim të mendimeve, udhëzimeve, rekomandimeve dhe praktikave më të mira të dhëna nga Bordi.

KREU VIII

Rrugët e zgjidhjes, përgjegjësia dhe penalitetet

Neni 52

E drejta për të bërë ankim pranë autoritetit mbikëqyrës

1. Pa cenuar rrugët e tjera administrative ose gjyqësore, Shtetet Anëtare garantojnë që çdo subjekt të dhënash të ketë të drejtën të bëjë një ankim tek autoriteti mbikëqyrës, nëse subjekti është i mendimit që përpunimi i të dhënave të tij/saj personale shkel dispozitat e miratuara në përputhje me këtë Direktivë.
2. Shtetet Anëtare garantojnë që autoriteti mbikëqyrës tek i cili është bërë ankimi e përcjell atë tek autoriteti kompetent mbikëqyrës pa vonesa të paarsyeshme, nëse ankimi nuk është bërë pranë autoritetit mbikëqyrës kompetent në përputhje me Nenin 45 (1). Subjekti i të dhënave informohet rreth përcjelljes.
3. Shtetet Anëtare garantojnë që autoriteti mbikëqyrës tek i cili është depozituar ankimi të ofrojë mbështetje të mëtijshme me kërkesë të subjektit të të dhënave.
4. Subjekti i të dhënave informohet nga autoriteti kompetent mbikëqyrës rreth ecurisë dhe rezultateve të ankimit, duke përfshirë mundësinë e një rruge gjyqësore në përputhje me nenin 53.

Neni 53

E drejta për një rrugë efikase gjyqësore ndaj një autoriteti mbikëqyrës

1. Pa cenuar rrugët e tjera administrative ose jogjyqësore, secili Shtet Anëtar garanton që çdo person fizik ose juridik të ketë të drejtën e një rruge efikase gjyqësore ndaj një vendimi ligjërishit detyruar të dhënë nga autoriteti mbikëqyrës ndaj tij.

2. Pa cenuar rrugët e tjera administrative ose jogjyqësore, çdo subjekt të dhënash ka të drejtën e përdorimit të një rruge efikase gjyqësore, nëse autoriteti mbikëqyrës, i cili është kompetent sipas nenit 45(1), nuk e trajton ankimin ose nuk e njofton subjektin e të dhënave brenda tre muajve për ecurinë ose rezultatin e ankimit të bërë në përputhje me nenin 52.
3. Shtetet Anëtare garantojnë që procedimet gjyqësore ndaj një autoriteti mbikëqyrës të fillohen në gjykatat e Shteteve Anëtare të cilat është ngritur autoriteti mbikëqyrës.

Neni 54

E drejta për një rrugë efikase gjyqësore ndaj një kontrolluesi ose përpunuesi

Pa cenuar asnjë rrugë të disponueshme administrative ose jogjyqësore, si dhe të drejtën për të bërë një ankim tek autoriteti mbikëqyrës në përputhje me nenin 52, Shtetet Anëtare garantojnë që çdo subjekt të dhënash të ketë të drejtë për një rrugë efikase gjyqësore, nëse ai ose ajo mendon se janë shkelur të drejtat e tij/saj të miratuara në përputhje me këtë Direktivë si pasojë e përpunimit të të dhënave të tij/saj personale në shkelje të këtyre dispozitave.

Neni 55

Përfaqësimi i subjekteve të të dhënave

Në përputhje me të drejtën procedurale të Shtetit Anëtar, Shtetet Anëtare garantojnë të drejtën e subjektit të të dhënave për të autorizuar një organ, organizatë ose shoqatë jofitimprurëse që është krijuar rregullisht në përputhje me të drejtën e një Shteti Anëtar, që ka objektiva ligjore që janë në interesin publik dhe është aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, të bëjë një ankim në emër të tij/saj dhe të ushtrojë të drejtat e përmendura në nenet 52, 53 dhe 54 në emër të tij/ saj.

Neni 56

E drejta për kompensim

Shtetet Anëtare garantojnë që çdo person, i cili ka pësuar dëm material ose jomaterial si pasojë e një operacioni të jashtëligjshëm përpunimi ose i ndonjë shkeljeje të këtyre dispozitave të miratuara në përputhje me këtë Direktivë, ka të drejtë të marrë kompensim për dëmin e pësuar nga kontrolluesi ose ndonjë autoritet tjetër kompetent në përputhje me të drejtën e Shtetit Anëtar.

Neni 57

Penalitetet

Shtetet Anëtare përcaktojnë rregullat për penalitetet e tjera për shkeljet e dispozitave të miratuara në përputhje me këtë Direktivë dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që ato të zbatohen. Këto penalitete duhet të jenë të efektshme, proporcionale dhe penguese.

KREU IX

Aktet zbatuese

Neni 58

Procedura e komitetit

1. Komisioni mbështetet nga komiteti i krijuar në përputhje me nenin 93 të Rregullores (BE) Nr. 2016/679. Komiteti në fjalë është komiteti në kuptimin e Rregullores (BE) Nr. 182/2011.
2. Kur referohet kjo pikë, zbatohet neni 5 i Rregullores (BE) Nr. 182/2011.
3. Kur referohet kjo pikë, zbatohet neni 8 i Rregullores (BE) Nr. 182/2011, shoqëruar nga neni 5 i po kësaj Rregulloreje.

*KREUX***Dispozitat e fundit***Neni 59***Shfuqizim i Vendimit Kuadër 2008/977/JHA**

1. Vendimi Kuadër 2008/977/JHA shfuqizohet duke filluar nga data 6 maj 2018.
2. Referimet te Vendimi i shfuqizuar të përmendur në pikën 1 interpretohen si referime te kjo Direktivë.

*Neni 60***Aktet ligjore në fuqi të Bashkimit**

Dispozitat specifike për mbrojtjen e të dhënave personale në aktet ligjore të Bashkimit që hynë në fuqi më 6 maj 2016 ose para kësaj date në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe bashkëpunimin policor, që rregullojnë përpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe aksesin e autoriteteve të përcaktuara të Shteteve Anëtare në sistemet e informacionit, të ngritura në përputhje me Traktatet brenda fushëveprimit të kësaj Direktive, do të mbeten të pandryshuara.

*Neni 61***Marrëdhënia me marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura më parë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe bashkëpunimin policor**

Marrëveshjet ndërkombëtare që përfshijnë transferimin e të dhënave personale te vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare që janë lidhur me Shtetet Anëtare para datës 6 maj 2016 dhe që janë në përputhje me të drejtën e Bashkimit, sipas rastit, para kësaj date, mbeten në fuqi deri në çastin e ndryshimit, zëvendësimit ose revokimit të tyre.

*Neni 62***Raportet e Komisionit**

1. Deri në datën 6 maj 2022 dhe pas kësaj date një herë në katër vjet, Komisioni paraqet një raport për vlerësimin dhe rishikimin e kësaj Direktive në Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Raportet bëhen publikë.
2. Në kontekstin e vlerësimeve dhe rishikimeve të përmendura në pikën 1, Komisioni shqyrton veçanërisht zbatimin dhe funksionimin e Kreut V për transferimin e të dhënave personale te vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare, duke bërë shumë kujdes për vendimet e miratuara në përputhje me nenin 36(3) dhe 39.
3. Për qëllimet e pikave 1 dhe 2, Komisioni mund të kërkojë informacion nga Shtetet Anëtare dhe autoritetet mbikëqyrëse.
4. Në kryerjen e vlerësimeve dhe rishikimeve të përmendura në pikat 1 dhe 2, Komisioni merr parasysh pozicionet dhe gjetjet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe të organeve ose burimeve të tjera përkatëse.
5. Nëse lind nevoja, Komisioni paraqet propozime të përshtatshme për ta ndryshuar këtë Direktivë, veçanërisht duke marrë parasysh zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe progresin në shoqërinë e informacionit.
6. Deri më 6 maj 2019, Komisioni rishikon akte të tjera ligjore të miratuara nga Bashkimi që rregullojnë përpunimin nga ana e autoriteteve kompetente për qëllimet e parashtruara në nenin 1(1), duke përfshirë ato të përmendura në nenin 60, për të vlerësuar nevojën për t'i bashkërenduar ato me këtë Direktivë, dhe, sipas rastit, të bëjë propozime për të ndryshuar ato akte, me qëllim që të garantohet një qasje të qëndrueshme për mbrojtjen e të dhënave personale brenda fushëveprimit të kësaj Direktive.

Neni 63
Transpozimi

1. Deri më 6 maj 2018, Shtetet Anëtare miratojnë dhe publikojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për përmbushjen e kësaj Direktive. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për tekstin e këtyre dispozitave. Dispozitat zbatohen nga data 6 maj 2018.

Kur Shtetet Anëtare t'i kenë miratuar këto dispozita, ato do të përmbajnë një referencë të kjo Direktivë ose do të shoqërohen nga një referencë e tillë me rastin e botimit të tyre zyrtar. Shtetet Anëtare përcaktojnë shkallën e referencës.

2. Përmes derogimit nga pika 1, një Shtet Anëtar siguron, në raste të veçanta, pa përpjekje të tepruara, që sistemet e përpunimit të automatizuar të krijuar para datës 6 maj 2016, të përshtaten me nenin 25(1) deri më 6 maj 2023.

3. Përmes derogimit nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, një Shtet Anëtar, në rrethana të jashtëzakonshme, mund të përshtatë një sistem të automatizuar përpunimi, siç përmendet në pikën 2 të këtij neni, në përputhje me nenin 25(1) brenda një afati të caktuar pas periudhës së përmendur në pikën 2 të këtij neni, përndryshe do të shkaktonte vështirësi në operimin e atij sistemi të caktuar të automatizuar përpunimi. Shteti Anëtar në fjalë njofton Komisionin për arsyet e vështirësive të mëdha dhe arsyen për periudhën e përcaktuar brenda së cilës ai e përshtat atë sistem të caktuar të automatizuar përpunimi me nenin 25 (1). Në asnjë rast, afati i përcaktuar nuk e kalon datën 6 maj 2026.

4. Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin rreth tekstit të dispozitës kryesore të ligjeve vendase që ata miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.

Neni 64

Hyrja në fuqi

Kjo Direktivë hyn në fuqi një ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian*.

Neni 65

Marrësit

Kjo Direktivë i adresohet Shteteve Anëtare.

Miratuar në Bruksel, 27 prill 2016.

Për Parlamentin
Evropian
Presidenti
M. SCHULZ

Për Këshillin
Presidenti
J.A. HENNIS-PLASSCHAERT

